



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. / Prot.

Tiranë, më / /2018

V E N D I M

Nr.103, Datë 31/07/2018

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË 9 SUBJEKTE
“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E
MËPARSHME TË EVADUARA NË PERIUdhËN E 9- MUJORIT TË VITIT 2017”.

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, gjatë auditimeve të evaduara gjatë vitit 2016 dhe 2017, sipas programit të auditimit nr. 555, datë 07.05.2018 si dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit nr. 1, datë 04.11.2016 “*Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, rezultoi se në **9** subjekte të audituar (Institucioni i Presidentit të Republikës, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Insitutin e Statistikave, Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara, pranë Ministrisë së Brendshme, Tiranë (ABP), Autoritetin Rrugor Shtetëror, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Europës dhe Punëve të Jashtme), janë rekomanduar gjithsej **(252)** masa, nga të cilat janë pranuar **(246)** masa dhe nuk janë pranuar 7 masa. Konstatuam se nga 246 masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht **97** prej tyre ose 39,4 %, pjesërisht **4** masa ose 0,01%, dhe konsiderohen në proces zbatimi **79** masa ose 32 %, dhe pa zbatuar **66** masa, të cilat përfaqësojnë 26.8%.

Analiza sipas llojit të rekomandimeve të dhëna paraqitet:

- 1. Masa për përmirësime ligjore** janë rekomanduar **14** nga të cilat janë pranuar **14** masa. Rezulton se nga masat e pranuar janë zbatuar **1** rekomandim, dhe në proces zbatimi **9** rekomandime dhe pa zbatuar 4.
- 2. Masa organizative** janë rekomanduar **(174)**, nga të cilat janë pranuar **(173)** masa ose 99 % e tyre, të pa pranuar 1 masa. Nga masat e pranuar, janë zbatuar **(81)** rekomandime, zbatuar pjesërisht **(4)** rekomandime, kanë nisur procedurat për zbatim **(57)** rekomandimeve dhe nuk janë zbatuar 32 rekomandime.
- 3. Masa zhdëmtimi** janë rekomanduar, **(36)** për vlerën 223,321 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar **(33)** masa në vlerën 207,488 mijë lekë dhe nuk janë pranuar **(3)** masa. Nga masat e pranuar, janë zbatuar **2** rekomandime në shumën 633,108 mijë lekë, në proces zbatimi **(11)** rekomandime për vlerën 101,336 mijë lekë dhe nuk janë zbatuar 20 rekomandime, për vlerën 105,518 mijë lekë.
- 4. Masa administrative** janë rekomanduar **10 masa**, nga të cilat janë pranuar **10** masa. Nga masat administrative të pranuar janë në proces zbatimi **2 masa dhe janë zbatuar 8 masa**.

5. Masa disiplinore janë rekomanduar **18**, në kompetencë të titullarit është rekomanduar **1** masë dhe *nuk është zbatuar*, janë pranuar **15** masa, nuk janë pranuar **3** masa disiplinore (nga Institucioni i MEPJ), **1** masë është pushuar për efekt të pushimit juridik të vlefshmërisë së veprimit (INSTAT). Nga masat disiplinore të rekomanduara janë zbatuar plotësisht **5** masë, dhe *nuk janë zbatuar 10 prej tyre*.

Në përputhje me kërkesat e nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, 8 subjekte e audituara kanë kthyer përgjigje brenda 20 ditëve në KLSH, mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportet përfundimtare të auditimit nga KLSH, sipas afateve të përcaktuara, një subjekt MEPJ nuk ka kthyer përgjigje por plani i masave ishte hartuar në kohë.

Gjithashtu konstatohet se, 4 (katër) subjekte nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 muajor në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, *konkretisht: (MEF;ARRSH;MEPJ; ndërkohë që Institucioni i Presidentit të Republikës, për shkak të ndryshimit të stafit nuk është bërë e mundur kthimi i përgjigjes, por të gjitha rekomandimet janë realizuar plotësisht brenda afateve të rekomanduara*).

Bazuar në rezultatet e mësipërme mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në periudhën e 9-mujorit të vitit 2017”, sipas programit të auditimit nr. 555, datë 07.05.2018, të ushtruar në 9 subjekte të audituara.

II. TË RIKËRKOJ marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si më poshtë:

1. AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE (AMA)

Nga auditimi i ushtruar në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA), për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 305/12, datë 8.11.2017, konstatohet se:

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Autoriteti i Mediave Audiovizive, ka kthyer përgjigje me shkresën nr.30502/1, datë 01.12.2017 sipas të cilës KLSH vihet në dijeni për marrjen e masave dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë **2(dy)** rekomandime, nga të cilat **janë në proces 2(dy)** rekomandime.
- b. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **8 (tetë) masa organizative**, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 8, nga të pranuarat **janë zbatuar plotësisht 2 (dy), 6 (gjashtë) në proces**.

- c. *Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 (tre) masa për shpërblim dëmi, nga të cilat nuk janë zbatuar 2 (dy) dhe është në proces 1(një).*
- d. *Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1(një) rekomandim për APP për vendosjen e gjobave për 8 (tetë) persona dhe masë disiplinore për 4 (katër) persona.*
- e. *Për përmirësimin e gjendjes për Autoritetin e Konkurrencës është lënë 1(një) rekomandim i cili është në proces.*
- f. *Për përmirësimin e gjendjes për Bordin e Mediave Audiovizive janë rekomanduara masa disiplinore për 6 (gjashtë) persona, nga të cilat 4(katër) janë pa zbatuar dhe 2(dy) janë zbatuar.*

Në përfundim **rikërkojmë** nga Autoriteti e Mediave Audiovizive (AMA), zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 305/12, datë 8.11.2017, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara si më poshtë:

A. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga zj. E. R. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Erjona Fishta me detyrë jurist, z. R. P, me detyrë arkitekt (i jashtëm) në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA” ka kualifikuar/shpallur padrejtësisht fitues BOEsh.p.k. me parregullsi në dokumentacionin ligjor kualifikues si më poshtë:

i. BOE..... sh.p.k. nuk ka përcaktuar në ofertë pjesën e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në kundërshtim me nenin 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2016 “Për rregullat e prokurimit publik” në të cilin është përcaktuar se ...Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. Në nenin 3 të kontratës së bashkëpunimit datë 10.2.2106 të noteruar lidhur midis palëve është përcaktuar shoqëria “.....” sh.p.k. do të ketë 7 për qind të fitimit dhe të pjesëmarrjes, shoqëria “.....” sh.p.k. do të ketë 30 për qind të fitimit dhe pjesëmarrjes. Nga sa më sipër konstatohet që në kontratën e bashkëpunimit palët (OE) nuk janë shprehur për pjesën e shërbimit, punës ... elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

ii. OE “.....” sh.p.k. nuk ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike për muajin janar, shkurt 2016, në kundërshtim me germën 2b të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” në zbatim të VKM nr. 379, datë 11.6.2014 shtesa të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar. Mos shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

iii. Kontratat e punës të lidhura midis OE “.....” sh.p.k. dhe punonjësve që parashikohen të kryejnë punën objekt prokurimi, nuk kanë vlerë pasi nuk janë të noteruara dhe personat nuk janë të përfshirë në listë pagesat ë shoqërisë.

Sa më sipër në kundërshtim me pikën 4 të pikës 2 të “Kriteret e veçanta të Kualifikimit” të shtojcës 9 të DST në të cilën ndër të tjera është përcaktuar se ... OE duhet të ketë një numër mesatar punonjësish të siguruar prej minimum 10. Për të vërtetuar këtë OE duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave, Për periudhën janar – dhjetor 2015, ... i shoqëruar me listë pagesë... Gjithashtu të gjithë drejtuesit teknikë duhet të jenë përfshirë në këto lista. Në projektet e ndryshme të zbatimit si elektrik, hidraulik etj, gjenden e 12 personave që mbulojnë shërbimin me kategoritë e punimeve që kanë në licencë, por në asnjë rast nuk është firma e tyre për projektin përkatës, psh për projektin elektrik të jenë firmat e dy inxhinierëve elektrikë të OE, H. Gj. (..... sh.p.k.) dhe M. M. (..... sh.p.k.). Në projekt zbatimin të dorëzuar (arkitektura fleta A4-01, A3-04, A3-03, A3-02, A3-01 etj, ka firmosur zj. A. K., e cila nuk gjendet në stafin, listë pagesat apo personelin e afruar nga OE të BOE. Me parregullsitë e konstatuara, KVO duhet të skualifikonte BOE “.....” sh.p.k. & “.....” sh.p.k. Me skualifikimin e tij, fitues rezulton “..... me ofertë ekonomike 2,161,000 lekë, ose 389,000 lekë më pak ndaj ofertës ekonomike të BOE “....” sh.p.k. & “.....”, e cila nën këtë arsyetim përbën dëm ekonomik.

1.1 Rekomandimi: Komisionit të vlerësimit të ofertave i përbërë nga zj. E. R. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, E. F me detyrë jurist, z. R. P. me detyrë arkitekt (i jashtëm) të zhdëmtojnë vlerën **389,000 lekë**, ose nga 129,667 lekë/secili, pasi në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA” ka kualifikuar/shpallur padrejtësisht fitues BOE “.....” sh.p.k. & “.....” sh.p.k. Me skualifikimin e tij, fitues do të rezultonte OE “.....” sh.p.k. me ofertë ekonomike 2,161,000 lekë, ose 389,000 lekë më pak ndaj ofertës ekonomike të BOE “.....” sh.p.k. & “.....”.

Menjëherë

1.2 Rekomandimi: Autoriteti kontraktor të kontabilizojë dhe të ndjekë në rrugë ligjore arkëtimin e tij, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

2. Lidhur me “Saktësinë e llogaritjes së fondit limit” në tenderin me objekt “Hartimi i projektpreventivit të zbatimit për rikonstruksionin e godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA”, me numër reference 22631, i zhvilluar në vitin 2016 me fond limit të llogaritur 49,999,949 lekë, i paraqitur/hartuar nga BOE “.....” sh.p.k. & “.....” sh.p.k. me z. A. D. drejtues ligjor dhe teknik (AVE) dhe OE “.....” me z. E. D. drejtues ligjor/teknik dhe V. Sh. drejtues teknik. Pasaktësi të konstatuara:

i. Në preventiv, në pjesën A-1 me numër/emërtim “Punime prishje...”: A-1.1. është përfshirë dhe zëri i punimeve “Ngritje, mobilim, mirëmbajtje ...” me analizë An me vlerë 236,078 lekë (187,364 x 1,05 fondi rezervë x 1.2 TVSH). A-1.2. është përfshirë dhe zëri i punimeve “Rrethim I përkohshëm me rretë teli” me vlerë 270,270 lekë (214,500 x 1,05 fondi rezervë x 1.2 TVSH). Përfshirja si zëra punimi me vete në preventiv/situacion i sa më sipër është në kundërshtim me germën B/3 të “Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi” të UKM nr. 2, datë 8.5.2003 në të cilën është përcaktuar se në shpenzimet e përgjithshme përfshihen Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, **skelat**, makineritë, tabelat sinjalizuese etj. Në zbatimin e punimeve të “Rikonstruksionit të godinës...” në preventivin fitues dhe në situacionin e punimeve për zërat e punimeve sipas A-1.1. dhe A-1.2 BOE “.....” sh.p.k. & “.....” sh.p.k. zbatuese e punimeve të tenderit, i janë likuiduar respektivisht **50,000 lekë** dhe **160,750 lekë**, ose 210,000 lekë gjithsej, të cilat nën arsyetimin e mësipërm janë përfituar padrejtësisht nga OE “Mela” sh.p.k. dhe përbëjnë **dëm ekonomik**.

ii. Pasaktësi e konstatuar: Në strukturën e kostos, në preventivin e hartuar/dorëzuar nga BOE “.....” sh.p.k. & “.....” sh.p.k., midis zërave të punimeve është përfshirë vlera e

pajisjeve me TVSH përkatëse, në kundërshtim me germën A/7 paragrafi i fundit i UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, e cila përcakton se në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat, si më poshtë: Në preventiv, në pjesën “Instalime hidro sanitare” zëri I punimeve me analizë 10, me emërtim “FV grup presioni I ujit të pijshëm ...” një copë me vlerë 314,000 lekë, e cila duhet të ishte vendosur/shtuar në fund të preventivit (pa u vlerësuar me TVSH). Në preventivin fitues të “Rikonstruksionit të godinës...” dhe në situacionin e punimeve të paraqitur nga BOE “.....” sh.p.k. & “..... sh.p.k. zbatuese e punimeve të tenderit, vlera e kësaj pajisje në preventivin fitues është 267,044 lekë, e cila është rritur me fondin rezervë prej 13,352 leke (I parashikuar në masën 5 për qind) dhe vlerën e TVSH prej 53,408 lekë, që përfaqëson pagesë/përfitim të padrejtë nga OE “....” sh.p.k., dhe nën këtë arsyetim është dëm ekonomik. I njëjti arsyetim për:- zërin e punimeve me numër rendor E2-4 “Analizë” “FV Detektor optik tymi me vetadresim të kompletuar me baza” të kapitullit E “Instalimi, sistemi I sinjalizimit kundra zjarrit” 46 copë me vlerë 257,600 lekë. Vlera e shtuar padrejtësisht është 66,896 lekë (nga e cila fondi rezervë 12,800 lekë dhe TVSH 54,096 lekë), e cila përbën dëm ekonomik.- zërin e punimeve me numër rendor Z-2.1 “Analizë” “FV Panel komandimi I impiantit të MKZ për një zonë detektimi dhe shuarje të zjarrit” të kapitullit Z-2 “Impianti I mbrojtjes nga zjarri – Arkiva” 1 copë me vlerë 85,000 lekë. Vlera e shtuar padrejtësisht është 22,100 lekë (nga e cila fondi rezervë 4,250 lekë dhe TVSH 17,850 lekë), e cila përbën dëm ekonomik. Gjithsej shuma dëm ekonomik (sipas pikës 2) është **366,504 lekë**.

1.1 Rekomandimi: BOE “.....” sh.p.k. & “..... partners” sh.p.k, t’i kërkohet të zhdëmtojë vlerën **366,504 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e TVSH, fondit rezervë etj, të pajisjeve të përfshira padrejtësisht në zërat e punimeve të preventivit gjatë llogaritjes së fondit limit në tenderin me objekt “Hartimi i projekt-preventivit të zbatimit për rikonstruksionin e godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA”.

Menjëherë

1.2 Rekomandimi: Autoriteti kontraktor të kontabilizojë dhe të ndjekë në rrugë ligjore arkëtimin e tij, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

3. Nga auditimi i fletë udhëtimeve që na u vunë në dispozicion dhe fletë daljeve të magazinës në disa muaj u konstatuan diferencë në karburant: Për vitin 2015 në sasi prej 935 litra karburant në vlerë 162,253 lekë, (dalje 6,458 dhe harxhuar sipas fletë udhëtimeve 5,523). Për vitin 2016 në sasi prej 460 litrash në vlerë 86,605 lekë (1,370 sipas fletë udhëtimeve dhe duke i krahasuar me daljet nga magazina për një sasi prej 1,830). Për dy vitet 2015, 2016 diferencat në karburant prej 1,395 litra nga të cilat 945 lira benzinë dhe 450 litra naftë me vlerë prej 248,858 lekë.

1.1 Rekomandimi: Të mbahet vlera prej 248,858 lekë për 1,395 litra karburant, diferencë nga krahasimi i dokumentacionit të fletë udhëtimeve me daljet nga magazine, personave përgjegjës të cilët në kundërshtim me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 të menaxhimit financiar dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, nuk kanë kryer akt rakordimet për monitorimin e harxhimit të karburantit duke çuar në mos përdorim korrekt të sasisë së karburantit nga drejtuesit automjeteve që dispononin.

Menjëherë

B. MASA DISIPLINORE

Bordi i AMA-së të analizojë Raportin e Auditimit dhe të marri masat bazuar në legjislacionin në fuqi. Për sa më poshtë:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt konstatimet dhe procesverbalet përkatës, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit. Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe neni 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor për shërbimin civil” Bordi i Autoriteti të Mediave Audiovizive, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e **masave disiplinore nga “vërejtje” deri në “largim nga detyra”**, në varësi të shkallës së përgjegjësisë për personat si më poshtë:

1. **Zj. A. K.** me detyrë Përgjegjëse Zyrës së Financës,
2. **Z. E. N.** me profesion inxhinier ndërtimi ekspert i jashtëm, në cilësinë e anëtarëve të KVO,

pasi në procedurën e zhvillimit të tenderit me objekt “*Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA*” ka kualifikuar e në vijim është shpallur fitues, Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë “....” sh.p.k. “....” sh.p.k. me parregullsitë si më poshtë:

a. OE “Mela” sh.p.k. në licencën e shoqërisë nuk ka kategoritë e punimeve:

- NP-12 “Punime të inxhinierisë së mjedisit”,
- NS-18 “Punime topogjeodezike”,
- NS- 19 “Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë”, në kundërshtim me pikën 2.a.I dhe 2.a.II të KVK të miratuara me DST.

OE “Mela” sh.p.k. në licencën e shoqërisë nuk ka Drejtues teknik të punësuar me kontratë pune të vlefshme të profesionit:

- Inxhinier topograf
- Inxhinier mjedisi,
- inxhinier telekomunikacioni.

Në staf, nuk ka të punësuar të punësuar me kontratë pune të vlefshme dhe të figurojnë në listë pagesa, një inxhinier mekanik dhe një ekspert zjarrfikës, në kundërshtim me pikën 2.C.2 dhe 2.C.4 të KVK të miratuara.

b. OE “Curri” sh.p.k. në licencën e shoqërisë nuk ka Drejtues teknik të punësuar me kontratë pune të vlefshme të profesionit:

- Inxhinier topograf
- inxhinier telekomunikacioni.

Në staf, nuk ka të punësuar të punësuar me kontratë pune të vlefshme dhe të figurojnë në listë pagesa, një inxhinier hidroteknik, një arkitekt dhe një mjek, në kundërshtim me pikën 2.C.2 dhe 2.C.4 të KVK të miratuara.

Nuk ka një mjet “autobot uji”. Mjeti i tipit benz me targë SH 4082 E i paraqitur në shtojcën 9 “Mbi disponimin e makinerive” si autobot uji, me kod “GA” në lejen qarkullimin e mjetit, nuk është “autobot uji”, por një kamion me përdorim tjetër.

Me parregullsitë e konstatuara KVO, duhet të skualifikonte BOE “Mela” sh.p.k. & “Curri” sh.p.k.

3. **Zj. E. R.** me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore,

4. **Zj. E. F.** me detyrë jurist,

pasi në tenderin me objekt “*Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA*” ka kualifikuar/shpallur padrejtësisht fitues BOE “.....” sh.p.k. & “.....” sh.p.k.

KVO me parregullsitë që kishte në dokumentacionin ligjor kualifikues duhet të kishte skualifikuar BOE “.....” sh.p.k. & “.....” sh.p.k. de të kishte kualifikuar dhe shpallur fitues OE “.....” sh.p.k. me ofertë ekonomike 2,161,000 lekë, ose 389,000 lekë më pak ndaj

ofertës ekonomike të BOE “.....” sh.p.k. & “.....”, e cila nën këtë arsyezim përbën dëm ekonomik

Për z. R. P. me detyrë arkitekt (i jashtëm) në cilësinë e anëtarit të KVO dhe z. F. D. në cilësinë e ekspertit të jashtëm në njësinë e prokurimit në tenderin me objekt “*Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA*”, për parregullsitë e konstatuara, nuk është rekomanduar masë disiplinore, pasi nuk janë punonjës i AMA.

Menjëherë

C.TË TJERA

1.Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2018.

2. INSITUTIN E STATISTIKAVE (INSTAT) .

Nga auditimi i ushtruar në Insitutin e Statistikave (INSTAT) *Tiranë* për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 330/8, datë 03.07.2017, konstatohet se:
-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në vijim të shkresës nr. 330/8, datë 03.07.2017, Instituti i Statistikave Tiranë, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, me shkresën nr.451/19, datë 24.07.2017 sipas të cilës KLSH vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku dërgon planin e veprimeve, duke përcaktuar pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.

-Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr.451/20 datë 07.08.2017 në vijim të shkresës nr. 451/19 prot, datë 24.07.2017 “Mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH” është lëshuar nga titullari i institucionit urdhëri i Brendshëm nr.9 datë 07.08.2017 “Për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH” mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 20 (njëzet) masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht dhe zbatuar 18, 1(një) rekomandim është në proces dhe 1(një) i pa zbatuar.*
- b. një masë për shpërblim dëmi, pa zbatuar.*
- c. një mbi përdorimin me eficensë, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve publike, pa zbatuar.*
- d. një masë disiplinore, i pa zbatuar për efekt të pushimit juridik të vlefshmërisë së veprimit.*

Në përfundim **rikërkojmë** nga Insituti i Statistikave (INSTAT) *Tiranë*, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 330/8, datë 03.07.2017, mbi auditimin me objekt “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara si më poshtë:*

A.MASA ORGANIZATIVE

1. INSTAT për vitin 2015 nuk ka realizuar inventarizimin e vlerave materiale dhe objekteve në pronësi, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financës nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kapitulli IV “Inventarizimi i aktiveve”. INSTAT në 2015 ka bërë zbardhjen e inventarit të 2014. (Trajtuar më hollësisht në faqe 85-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandoj:

Nga ana e INSTAT të merren masa për nxjerrjen e përgjegjësisë për mos kryerjen e inventarizimit të vlerave materiale dhe objekteve në pronësi, për vitin 2015.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit ekonomik, **në shumën 85,000 lekë**, përfituar në kundërshtim me ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar, nenin 10/1, si dhe me VKM-në nr.999 datë 25.10.2013 “Për kriteret dhe procedurat e përfaqësimit, të përzgjedhjes, të emërimit e të shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave” pika 20, si më poshtë:

1. Dh. T., vlera 34,000 lekë;
2. M. M., vlera 10,200 lekë;
3. R. L., vlera 10,200 lekë;
4. D. Sh., vlera 10,200 lekë;
5. V. N., vlera 10,200 lekë;
6. I. M., vlera 10,200 lekë;

C. MBI PËRDORIMIN ME EFICENSË, EFIKASITET DHE EKONOMICITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Përdorim pa efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publik me vlerë prej 60,000 lekë pa TVSH, për shkak se realizimi i procedurës prokuruese është realizuar në formë shkresor. Kështu me Urdhër Prokurimi nr.36 datë 28.12.2015 (si vazhdimësi të monitorimit të procedurës me objekt “Blerje chilleri për Institutin e Statistika”, me fond limit 5,400,000 lekë, pa tvsh, për vitin 2015), është iniciuar dhe e realizuar në procedurë tenderuese të gabuar, në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimit dhe me kërkesat e menaxhimit financiar.

Për këtë rekomandoj:

Autoriteti kontraktor, i INSTAT-it, për çdo prokurim publik të financuar nga buxheti i shtetit, të marrë masa për zbatimin dhe monitorimin e plotë të tyre, në përputhje me bazën ligjore të prokurimeve, në mënyrë që të rritet performanca e qëllimit të realizimit të procedurave tenderuese, duke siguruar dokumentimin e plotë vërtetues, ligjor, teknik dhe financiar. Të përcaktohen procedura të standardizuara jo vetëm të monitorimit por edhe në planifikimin e tyre dhe të ketë përgjegjësi të përcaktuar funksionale brenda Institucionit për këtë proces.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm dhe Këshillit të Statistikave të analizojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe ti kërkojë Komisionit

Disiplinor, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore, për punonjësit e përmendur në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

E.TË TJERA.

1. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2018.

3. AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA, PRANË MINISTRISË SË BRENDSHME, TIRANË (ABP), (ish-Drejtorinë e Prokurimeve të Përqëndruara (DPP)).

Nga auditimi i ushtruar në ish Drejtorinë e Prokurimeve të Përqëndruara (DPP) sot Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, pranë Ministrisë së Brendshme, Tiranë (ABP), për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 618/7, dt 26.9.2017, konstatohet se:

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ish Drejtoria e Prokurimeve të Përqëndruara, ka kthyer përgjigje me shkresën nr.4422/11, datë 19.12.2017 sipas të cilës KLSH vihet në dijeni se, me shkresën nr.4422/10, datë 5.12.2017 është ngritur grupi i punës për përgatitjen e programit të punës për marrjen e masave dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

- Në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr.4422/14, datë 16.5.2018, ish DPP ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

g. Për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore janë lënë 2(dy) rekomandime, nga të cilat është pa zbatuar 1(një) rekomandim.

h. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 8 (tetë) masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 7, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 4 (katër), janë në proces 2 (dy), pa zbatuar 2 (dy)

Në përfundim rikërkojmë nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, pranë Ministrisë së Brendshme, Tiranë (ABP), zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 618/7, dt 26.9.2017, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara si më poshtë:

A. NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1.Nga auditimi i procedurave të prokurimit objekt “Blerje automjetesh” dhe “Shërbim Katering II”, në seancën publike të hapjes së ofertave në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) konstatohet se, operatorët nuk publikojnë ofertën ekonomike ose dokumentacionin ligjor/teknik të kërkuar. Për rrjedhojë sigurohet konkurrenca numerike në fazën publike të hapjes së ofertave, por jo konkurrenca në përzgjedhjen e ofertës. Kjo mënyrë konkurimi i hap rrugën për kualifikim dhe shpall fitues, operatorin e mbetur në garë (pa u futur në proces konkurimi) si e vetmja alternativë, duke lënë shteg për ekzistencën e marrëveshjeve të fshehta mes operatorëve ekonomikë, fenomen për të cilin Autoriteti Kontraktor (OQB) duhet të sinjalizojë Autoritetin e Konkurrencës si organ kompetent i hetimit të sjelljes anti konkurruese të operatorëve ekonomikë. Për pasojë, mos publikimi nga operatorët ekonomikë i ofertës ekonomike apo i dokumentacionit të tenderit në SPE, mund të kufizojnë konkurrencën e drejtë dhe efektive, duke mos nxitur dhe inkurajuar biznesin e vogël dhe të

mesëm kushti kryesor për realizimin e objektivit dhe qëllimit të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 1, si dhe direktivave të BE.

Për këtë rekomandoj:

-Të merren masa nga Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara për të kërkuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, përmirësime ligjore e cila bazuar në nenin 13, pika 2/a ka të drejtën të paraqesë në Këshillin e Ministrave propozime për rregullat e prokurimit, për përmirësime në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime, neni 73, paragrafi parë. Në një procedurë prokurimi që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit, duhet të pranohet minimumi 1 (një) ofertë e vlefshme e dalë nga konkurimi në sistem dhe jo nga publikimi në SEP të ofertës, në mënyrë që t’i pritët rruga konkurrencës fiktive nga operatorët ekonomikë, pjesëmarrës të marrëveshjeve të fshehta në oferta.

Për këtë qëllim, neni 73 paragrafi parë, në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime, të riformulohet duke u bërë ndryshimi si më poshtë:

Ishte:

“Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në një procedurë prokurimi, duhet të pranohet të paktën 1(një) ofertë e vlefshme”.

Bëhet:

“Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në një procedurë prokurimi, duhet të pranohet minimumi 1(një) ofertë e vlefshme e cila plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit”.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE:

1.Nga auditimi mbi llogaritjen e fondit limit dhe shqyrtimit të kërkesave, të paraqitura nga Autoritet Kontraktore ka rezultuar se:

Në përcaktimin e fondit limit, Titullari i OQB ka nxjerrë urdhrin nr. 1493, datë 09.12.2015 për testimin e tregut për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyresh”. Pas publikimit të ftesës për ofertë, 4 operatorë ekonomikë kanë dërguar ofertat së bashku me specifikimet teknike, në bazë të të cilave OQB ka përlllogaritur çmimet/njësi, si mesatare e çmimit për çdo artikull. Paraqitja e kërkesave nga AK-të, duhet të bëhej deri më datë 31.01.2016 në zbatim të VKM-së nr. 28, datë 14.01.2015. Disa Autoritete i kanë sjellë me vonesë kërkesat, për rrjedhojë, nxjerrja e urdhrin të më sipërm, pa patur dijeni mbi kërkesat e AK si dhe dërgimi i këtyre “çmimeve mesatare të testuara” për referencë AK-ve, është në tejkalim të kompetencave që aktet ligjore dhe nënligjore i kanë dhënë OQB, duke vepruar në kundërshtim me:

-VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 2, pika 5,

-VKM nr. 28, datë 14.01.2015, pikën 2, 3 dhe 4,

-udhëzimin nr. 1, datë 27.01.2015 pika 2,3 dhe 4.

Për këtë rekomandoj:

Titullari i Organit Qendror Blerës, të marrë masa për ndërprerjen e një praktike të tillë, e cila është jashtë kompetencave që aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative i njohin OQB, pasi ajo, nuk ka kompetencë krijimin e manualeve të çmimeve referuese, por vetëm përpunimin, unifikimin e të dhënave të ardhura nga Autoritetet Kontraktore, duke bërë nëse është e nevojshme edhe testim të tregut pas paraqitjes së kërkesave nga AK.

Menjëherë

2. Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, konstatohet:

Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara me shkresën nr. 3624/25, datë 03.4.2017 ka kthyer përgjigje shkresës së KLSH nr. 606, datë 4.10.2016 për dërgim rekomandimesh. Nga zbatimi i rekomandimeve rezulton se DPP ka pranuar rekomandimet, ka nxjerrë urdhrin për

zbatimin e tyre dhe ka hartuar planin e veprimeve dhe në përfundim gjendja për zbatimin e rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

-Rekomandime “Propozime për përmirësime në legjislacionin në fuqi” janë propozuar 5 masa të cilat janë pranuar nga DPP duke u përcjellë me shkresë në APP e cila nuk i ka pranuar me argumentin përkatës për çdo rekomandim.

-Rekomandime “Masa organizative” janë propozuar 6, të cilat janë pranuar nga DPP dhe janë zbatuar 4 masa. Rekomandimi nr. 2, për krijimin e një regjistri me të dhëna mbi kërksat e autoriteteve kontraktore (sasinë e mallrave, punëve apo shërbimeve të kërkuara, fondi limit i parashikuar, fondi limit sipas urdhrit të nxjerrë, vlera e shpallur fituese, emri i operatorit fitues etj.) nuk është zbatuar për shkak të mungesës së burimeve njerëzore si dhe rekomandimi nr.6, mbi arkivimin e dosjeve të tenderave zhvilluar në vitin 2015 nuk është zbatuar.

-Rekomandim “Masa për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike” janë propozuar 3, të cilat janë zbatuar.

-Rekomandime “Masat disiplinore” janë propozuar 8 të cilat janë pranuar nga DPP dhe janë marrë në shqyrtim për fillimin e procedurave disiplinore. Në përfundim me vendimet Nr. 2259/4, datë 23.03.2017, Nr. 2259/5, datë 23.03.2017, Nr. 2259/6, datë 23.03.2017, Nr. 2259/7, datë 23.03.2017, Nr. 2259/8, datë 23.03.2017, Nr. 2259/9, datë 23.03.2017, Nr. 2259/10, datë 23.03.2017, Nr. 2259/11, datë 23.03.2017 është vendosur mos fillimi i procedimit disiplinor ndaj tyre, pasi gjykohet se punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi nga KLSH, kanë vepruar në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Rekomandimet e KLSH për fillimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësve nuk janë zbatuar.

Për këtë rekomandoj:

-Me qëllim përmirësimit të gjendjes, rikërkohet zbatimi i rekomandimeve që nuk janë zbatuar, të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH dërguar me shkresën nr. 606, datë 4.10.2016 dhe konkretisht rekomandimi nr. 6 “Masa organizative” sipas të cilës “OQB të marrë masat për të arkivuar dosjet e tenderave të zhvilluar gjatë vitit 2015 dhe 2016 sipas përcaktimeve të ligjit “Mbi arkivat” si dhe rekomandimet për “masa disiplinore” ndaj 8 punonjësve të ngarkuar me përgjegjësi.

Brenda vitit 2018

C.TË TJERA

1.Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2018.

4.MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, (Ish- Ministrinë e Shëndetësisë (MSH).

Nga auditimi i ushtruar në ish *Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) sot Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 449/9, datë 8.8.2017, konstatohet se:

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ish Ministria e Shëndetësisë, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 2196/46 datë 29.8.2017 sipas të cilës KLSH vihet në dijeni se, Programi i punës bazuar në rekomandimet e lëna ka përcaktuar detyrat përkatëse për çdo drejtori në Ministri.

- Në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr.2578/1, datë 19.4.2018, ish MSH ka kthyer përgjigje në KLSH “Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve dërguar me shkresën nr. 2196/46 datë 29.8.2017” mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 22(njëzetedy) masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 8(tetë), pa zbatuar 4(katër), në proces 9(nëntë), pjesërisht 1 (një) rekomandime.
- b. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 7(shtatë) rekomandime për shpërblim dëmi, nga të cilat janë zbatuar 2(dy), pa zbatuar 4(katër), në proces 1(një).
- c. Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 (një) masë disiplinore e cila nuk është zbatuar.

Në përfundim **rikërkojmë** nga *Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*, zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 449/9, datë 8.8.2017, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara si më poshtë:

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi konstatohet se programimi është prekur nga Aktet Normative. Gjithashtu konstatohet se Planifikimi i Buxhetit Afatmesëm nuk i referohet vitit paraardhës për të minimizuar ndryshimet e ndjeshme të cilat ndodhin kur përballemi me faktin në fund të vitit, duke krijuar kështu mosrealizim të shpenzimeve korrente dhe kapitale.

Për këtë rekomandoj:

Strukturat drejtuese të Ministrisë së Shëndetësisë, dhe strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e shpenzimeve, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përlllogaritjes së kostos, me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve mes nivelit të programuar dhe atij të realizuar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Raportet e monitorimit për periudhën objekt auditimi, si dhe raportet periodike që institucioni ka paraqitur në Ministrinë e Financës, nuk janë plotësuar me një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve si në sasi ashtu edhe në vlerë në kundërshtim me pikën 79 të udhëzimit plotësues nr. 1, date 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”. Mungojnë argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikojnë në të ardhmen për realizimin e tyre. Performanca e produkteve duhet të paraqitet e lidhur me realizimin e objektivave dhe politikës së programit, ku të shpjegohej cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e programit si dhe si janë realizuar këto objektiva.

Për këtë rekomandoj:

Strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Shëndetësisë për planifikimin dhe monitorimin e shpenzimeve buxhetore gjatë hartimit të raportit të monitorimit dhe raporteve periodike të cilat dorëzohen në Ministrinë e Financës, duhet të bëjnë argumentimet si cilësore ashtu dhe sasiore, si dhe të argumentojnë mosrealizimin e produkteve dhe të parashikojnë masat që duhet ndërmarrë në të ardhmen për realizimin e tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në lidhje me regjistrimin e pasurive të paluajtshme të Aparatit të MSH edhe pas urdhrin të nxjerre nga Titullari i ministrisë me nr. 158, datë 15.04.2016 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore që do të mbeten në administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë”, i cili u është dërguar njësisë të varësisë së bashku me metodologjinë e punës për kryerjen e këtij procesi, ku është përcaktuar dhe afati i përgatitjes së materialit, që ka qenë muaji Shtator 2016, u konstatua se nuk është bërë regjistrimi i pasurisë së sipërfaqes së truallit të përgjithshëm dhe i ndërtesës së Ministrisë, nuk është aplikuar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe

nuk është përgatitur dokumentacioni përkatës. në kundërshtim me ligjin nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria Shërbimeve Mbështetëse bashkë me Drejtorinë e Financës, të marrë masa për të ndjekur procesin e përgatitjes së dokumentacionit dhe regjistrimin e pasurisë së patundshme në zbatim të ligjin nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe urdhrin të ministrit nr. 158, datë 15.04.2016.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Nga verifikimet me zgjedhje në objektin “*Ndërtim i maternitetit të ri dhe shtesë dy kate për shërbimin e kirurgjisë dhe të patologjisë në Spitalin Sarandë*” të disa zërave të punimeve bazuar librezave të masave dhe projektit të azhurnuar (pjesor), u konstatuan disa mospërputhje të sasive të likuiduara. Verifikimet u realizuan kryesisht në zërat dyer, dritave, vetrata duralumini, punimeve të shtresave dhe disa specifikime teknike të pajisjeve mekanike.

-Nga verifikimet e "shtresës me pllaka “gres porcenalato” të disa ambienteve të maternitetit, u konstatuan mospërputhje midis faktit dhe librezës së masave. Mospërputhjet variojnë nga 10 deri në 20 cm të dimensioneve të ambienteve në masën rreth 3-5 %. Rrjedhimisht këto mospërputhje i përkasin edhe zërave të "shtresë lustër çimento nën pllakave", "mbushje në dysheme me beton të lehtësuar", "shtresë me PVC në sallat e lindjes dhe sallat e operacionit”

Nga verifikimet e dyerve të brendshme tamburato, të dritareve duralumini, u konstatuan mospërputhje në dimensione (gjatësi, gjerësi, me mospërputhje deri në 10 cm).

Zërat e mësipërm nuk kanë kaluar ende sasinë e parashikuar në preventiv dhe nuk janë likuiduar plotësisht.

-Dy pajisjet në vlerën 3,250,000 lekë (me TVSH) duhet të shoqërohen me Certifikatë origjine, test raporti i fabrikës, certifikatën e siguracionit, certifikata e garancisë, dokumentin e transportit (CMR) etj, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën shoqëria "Gjiguria" sh.p.k & “Arti” sh.p.k " shpk, ka fituar tenderin dhe është likuiduar në situacionin 7.

Për pasojë, Grupi i Auditimit, nuk mund të jepte opinion e tij, për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve që janë likuiduar.

Për këtë rekomandoj:

Nga mbikëqyrësi i punimeve duhet të verifikohen volumet faktike në mënyrë që të përputhen dokumentacionet faktike të objektit në situacionet pjesore dhe situacionin përfundimtar, të verifikueshme me librezën e masave dhe projektit të azhurnuar.

Gjithashtu për pajisjet në vlerën 3,250,000 lekë me TVSH, likuidimi të bëhet vetëm pas vendosjes së tyre në objekt dhe pasi të plotësohet praktika dokumentare, që të konfirmohet se pajisjet janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimet teknike) dhe të kontraktuar.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, ku dëmi ekonomik në total është në shumën prej **26,823,830 lekë** i rekomandojmë Ministrisë së Shëndetësisë, marrjen në shqyrtim të tyre, kontabilizimin dhe ndjekjen në rrugë ligjore arkëtimi i tyre, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “.....” **shpk**, ka përfituar vlerën **3,250,000 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e dy pajisjeve të pavendosura akoma në objekt por të situacionuara dhe të likuiduara në kontratën me objekt “*Ndërtim i maternitetit të ri dhe shtesë dy kate për shërbimin e kirurgjisë dhe të patologjisë në Spitalin Sarandë*”, të cilat nga verifikimi në objekt rezultuan të pavendosura.

Në total shuma e dy pajisjeve në vlerën 3,250,000 lekë (me TVSH) përbën dëm ekonomik, deri në instalimin e plotë, kolaudimit përfundimtar të tyre, duke realizuar verifikimet në përputhje me karakteristikat e pajisjeve. Pra në momentin e verifikimit të specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimet teknike).

Për këtë rekomandojë:

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe mbikëqyrësi i punimeve duhet të merren masa që nga operatori ekonomik “.....” **sh.p.k** te instalohen menjehere ne objekt dy pajisjet e munguara në vlerën 3,250,000 lekë (me TVSH) dhe gjate instalimit dhe kolaudimit përfundimtar të tyre, të verifikojë përputhshmërinë me karakteristikat e ketyre pajisjeve, në mënyrë që të konfirmohet se këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike) dhe te kontraktuara.

Menjëherë

2. Operatori ekonomik “.....” **sh.p.k**, nga verifikimet në objektin e fizioterapisë dhe situacionit nr. 2, konstatohet se i janë paguar zërat e furnizimit të pajisjeve të sistemit të monitorimit të CCTV, në vlerën **150,000 lekë** të cilat akoma nuk janë vendosur në objekt.

Për këtë rekomandojë:

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe mbikëqyrësi i punimeve duhet të merren masa që sipërmarrësit operatorit ekonomik “.....” **sh.p.k**, ti zbritet vlera e pajisjeve në situacionin pasardhës dhe të paguhet vetëm pas vendosjes në objekt, duke verifikuar përputhshmërinë me karakteristikat e pajisjeve, në mënyrë që të konfirmohet se këto pajisje janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimet teknike).

Menjëherë

3. Operatorit ekonomik “.....” **sh.p.k** me shkresën nr. 83 prot. datë 31.05.2017 të mbikëqyrësit drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, kërkon miratimin e fondit shtesë prej 9,702,825 lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, argumentimet mbi rritjen e sasive (volumeve) të projektit, në fazën kur janë të përfunduara punimet në nën/objektet e farmacisë dhe fizioterapisë janë të pajustificuara dhe të paargumentuara. Ndryshimet e volumeve nuk janë në përputhje me nenet e kontratës së punimeve dhe në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar "Për prokurimin publik", VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Mungesa e dokumentacioneve justifikuese dhe argumentuese, tregon pasaktësi të sasive dhe fondi shtesë i kërkuar i pa argumentuar.

Sa më sipër nga mungesa e dokumentacionit mbi justifikimet apo argumentimet e rritjes së sasive të volumeve të punimeve në vlerën prej **9,702,825 lekë me TVSH, përbën dëm ekonomik në përfitim të sipërmarrësit deri në momentin e justifikimit të sasive faktike të projektit**. Nga autoriteti kontraktor dhe mbikëqyrësi i punimeve nuk është ngritur grup pune për të verifikuar sasi të faktike në objekt me vlerë prej 9,702,825 lekë e pajustificuar me librezë masash. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar.

Për këtë rekomandojë:

Nga Ministria e Shëndetësisë duhet të ngrihet një grup pune për të verifikuar përputhjen e volumeve në librezat e masave me objektin, në mënyrë që të justifikohen rritjet e tyre, për shtesën e fondit te kerkuar prej 9,702,825 lekë, duke hartuar një relacion të detajuar se bashku me mbikeqyresin e punimeve, mbi të gjitha zërat e punimeve. Dokumentacioni justifikues duhet të jetë në përputhje me ligjin 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar dhe me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

Menjëherë

4. Operatorit ekonomik “.....” **sh.p.k**, në vlerën **12,760,149 lekë** vlera e fondit shtese te kerkuar dhe te miratuar nga mbikeqyresi i punimeve përbën dëm ekonomik në përfitim të sipërmarrësit deri në momentin e justifikimit të sasive faktike të projektit me objekt "Rikonstruksionin e ambienteve ku do te instalohen pajisjet që do të furnizohen nga kredia

Italiane e Traumës". Mungesa e dokumentacionit mbi justifikimet apo argumentimet e rritjes së sasive të volumeve të punimeve në vlerën prej 12,760,149 lekë, pa u verifikuar sasitë faktike në objekt e pajustificuar me librezë masash, e cila përfaqëson vlerën e përfituar padrejtësisht për shkak të mungesës së dokumentacionit.

Për këtë rekomandojë:

Nga Ministria e Shëndetësisë duhet të ngrihet një grup pune për të verifikuar përputhjen e volumeve në librezat e masave me objektin, në mënyrë që të justifikohen rritjet e tyre, në vlerën prej 12,760,149 lekë, duke hartuar një relacion të detajuar se bashku me mbikëqyrësin e punimeve mbi të gjitha zërat e punimeve. Dokumentacioni justifikues duhet të jetë në përputhje me ligjin 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*" i ndryshuar, dhe me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar "*Për prokurimin publik*".

Menjëherë

C. MASË DISIPLINORE

Për personat përgjegjës në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet titullarit të institucionit të Ministrisë së Shëndetësisë për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore sipas përgjegjësisë individuale të personave konkret, nga vërejtje deri në largim nga puna.

Menjëherë

D. TË TJERA

1. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2018.

2. Për rekomandimet e pazbatuara që lidhen me shpërblimin e dëmeve, kërkojmë edhe njëherë **që, brenda muajit shtator 2018**, të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të bërë të mundur kthimin e këtyre fondeve buxhetore në arkën e shtetit.

Nëse, në përfundim të këtij afati, këto rekomandime **do të rezultojnë përsëri të pazbatuar**, KLSH në zbatim të nenit 15 germa "gj" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", do të bëjë për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, **kallëzim penal në Organet e Prokurorisë** si dhe do të njoftojmë Komisionin Parlamentar për Ekonomin dhe Financat.

5. MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME (*ish-Ministria e Puneve të Jashtëme*).

Nga auditimi i ushtruar në ish *Ministrinë e punëve të Jashtëme (MEPJ)* sot Ministria e Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën e KLSH-së nr. 509/13, datë 06.10.2017, konstatohet se Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH, dërguar me shkresën nr. 509/13, datë 06.10.2017, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

- Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Hartimi i programit (*Planit të veprimit*), si dhe respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh nga data e marrjes së kërkesës për informimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (germa "j" e nenit 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014.

- Nga auditimi rezultoi se, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, me nr. 509/13, datë 06.10.2017, për shkak të ristrukturimit të institucionit në nivel strukturor dhe organizativ, por plani i

zbatimit të masave është hartuar duke cilësuar edhe personat përgjegjës dhe afatet e përcaktuara.

- Në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga, ish MPEJ nuk ka kthyer përgjigje në KLSH “Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **27 masa organizative**, nga të cilat 7 janë zbatuar plotësisht, janë në proces zbatimi 10, janë të pa zbatuara 8, ndërsa 2 masa janë të pranuar pjesërisht dhe të zbatuara pjesërisht.
- b. Masa për shpërbllim dëmi janë lënë **5 rekomandime** për shumën 16,928,125 lekë dhe 150 Euro nga të cilat, nuk janë pranuar 3 dhe 2 janë në proces.
- c. Rekomanduar **1** masë disiplinore, e cila nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar nga titullari.

Në përfundim **rikërkojmë** nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën e KLSH-së nr. 509/13, datë 06.10.2017., mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Detyrimi i (llog. 468) “Debitorë të ndryshëm” në fund të vitit 2016 rezulton në vlerën 489,528 lekë i cili paraqet detyrimet e subjekteve private dhe punonjësve ndaj institucionit. Pra i zbërthyer në mënyrë analitike përbëhet nga detyrimet e 10 subjekteve të cilat nuk kanë derdhur asnjë vlerë nga detyrimi për një periudhë 5 vjeçare. (Më hollësisht trajtuar në pikën III/4, faqe 26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 1

Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të kërkohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i debitorëve, duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme administrative, deri në arkëtimin e vlerës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Nga auditimin i zbatimit të procedurave të blerjes së automjeteve për Përfaqësitë Shqiptare jashtë shtetit u konstatua:

A. Me Urdhër shpenzimin nr. 139, dt. 21.10.2014 është transferuar fondi për llogari të ambasadave në vlerën 21,158,635 lekë. Ky fond është transferuar për ambasadat e mëposhtme në vlerën 150,000 EURO;

Ambasada Paris për 30,000 EURO, Ambasada Berlin për 30,000 EURO, Ambasada Lubjana për 30,000 EURO, Ambasada Zagreb për 30,000 EURO, Ambasada Prishtinë për 30,000 EURO.

Ambasadat e mësipërme, kanë dërguar në Drejtorinë e Programit Buxhetor dhe të Financës, proces verbalet e mbajtura nga komisionet për përzgjedhjen e ofertave për blerjen e automjetit protokollar të ambasadës ku bashkëngjitur janë tre ofertat e marra nga komisionet dhe ajo fituese.

Me shkresat përkatëse Sekretari i përgjithshëm i është drejtuar Ministrit për miratimin e ofertave fituese të propozuar nga Drejtoria e Programimit Buxhetor dhe Financës, të miratuara nga Ministri.

Nga verifikimi i inventarëve të dërguara nga Ambasadat e mësipërme me shkresat përkatëse rezultoi se në inventarin e automjeteve në administrim të përfaqësive krahas automjeteve të

tjera rezultojnë edhe automjetet e blera nga përfaqësitë gjatë vitin 2014 sipas ofertave fituese.

U konstatua:

1. Nga Ambasada Paris fondi limit i miratuar dhe Oferta fituese e miratuar është 31,548 Euro kurse vlera e blerjes sipas inventarit të mësipërm është 32,329.64 Euro. Vlera e ofertës është tejkaluar me **781.64** Euro.
2. Nga Ambasada Lubjanë mungon proces verbali i mbajtur nga komisioni për përzgjedhjen e ofertave për blerjen e automjetit protokollar të ambasadës. Bashkëngjitur është vetëm një ofertë.
3. Nga Ambasada Zagreb mungon proces verbali i mbajtur nga komisioni për përzgjedhjen e ofertave për blerjen e automjetit protokollar të ambasadës.
4. Nga Ambasada Prishtinë mungon proces verbali i mbajtur nga komisioni për përzgjedhjen e ofertave për blerjen e automjetit protokollar të ambasadës.
5. Procedura e blerjes së këtyre automjeteve nuk është kryer e përqendruar nga Ministria e Punëve Brendshme në kundërshtim me VKM nr. 53, dt. 21.01.2009 “Për ngarkimin e ministrisë së brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë për disa mallra e shërbime” i ndryshuar (shfuqizuar me VKM nr. 28, dt. 14.01.2015) pika 1. Ngarkohet e Ministria e Brendshme, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të kryeministrit e të ministrive të linjës, për blerjen e mallrave dhe shërbimeve si..... Blerje automjetesh, etj...

B. Me Urdhër shpenzimit nr. 180, dt. 31.12.2014 është transferuar fondi për llogari të ambasadave në vlerën 30,000,000 lekë. Ky fond është transferuar për ambasadat e mëposhtme në vlerën 211,348 EURO:

Misioni NATO-s Bruksel për 150,000 EURO. Misioni i BE-së Bruksel për 61,348 EURO. Bashkëngjitur urdhër shpenzimit janë urdhri i transferimit i datës 31.12.2014 i firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm me vlerat përkatëse në euro për secilën nga përfaqësitë e mësipërme. Ky fond është transferuar në llog. e misioneve të mësipërme me arsyetimin për të mos u djegur në fund të vitit 2016.

- Memorandumi për vendimmarrje nr. 48/1, dt. 25.02.2015 nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm i është drejtuar Ministrit ku i kërkohet miratimi për procedurën që duhet të ndiqet për prokurimin e automjeteve për përfaqësitë ku argumentohet se zhvillimi i procedurave të prokurimit nga vetë përfaqësitë ka hasur në vështirësi në realizimin e tyre, si pasojë e mungesës së personelit dhe kualifikimit të tyre në fushën e prokurimeve publike. Për rrjedhojë MPJ duhet të vlerësojë përcaktimin e procedurës së prokurimit, bazuar në gjendjen faktike të personelit në dispozicion të çdo përfaqësie për të cilën është dhënë miratimi si dhe për procedurat që do të ndiqen në vlerësimin e ofertave..... Në lidhje me procedurën e vlerësimit sugjerohet që KVO e miratuar nga ministri me nr. 59, dt. 04.03.2015 mbasi të grumbullojë ofertat e përcjella nga përfaqësitë duhet të vlerësojë ofertën në bazë të rregullave të prokurimit publik bazuar në ofertën me çmimin më të ulët. Ky memorandum është miratuar edhe nga Ministri.

- Me memorandum për vendimmarrje të datës 19.03.2015 e KVO është miratuar nga ministri sugjerimi për ofertat e përzgjedhur nga KVO dhe janë miratuar blerja e artikullit automjete për pajisjen me autoveturë protokollare të përfaqësive; Stokholm, Varshavë, Bari, Pragë, Misioni i BE, Bukuresht dhe Sofje.

- me shkresën nr. 6845, dt. 15.04.2015 drejtuar konsullatës së përgjithshme të Shqipërisë në Bari nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse është dërguar udhëzimi që në zbatim të urdhrit të firmosni kontratën për blerjen e automjeteve me koncesionarin Mercedes Benz në Bari, me ofertën **32,400** Euro.

- Nga verifikimi i inventarëve dhe kontratave të dërguara nga përfaqësitë rezultoi se në inventarin e automjeteve në administrim të përfaqësive krahas automjeteve të tjera rezultojnë automjete e blera për vitin 2015.

U konstatua:

- Likuidimi i vlerës së blerjes së automjeteve është kryer nga përfaqësitë nga llogaria e tyre e çelur sipas transfertave nga llog. 600, 601, 602, 605 dhe jo nga llog 231 për të cilën gjatë vitit 2015 nuk ka çelje përkatësish për përfaqësitë që kanë kryer likuidimin e vlerave për automjetet e blera si: Stokholm, Varshavë, Bari, Pragë, Misioni i BE, Bukuresht.

- Nga verifikimi i inventarëve dhe kontratave të dërguara nga përfaqësitë rezultoi se në inventarin e automjeteve në administrim të përfaqësive krahas automjeteve të tjera rezultojnë automjete e blera për vitin 2015 me ndryshimin në:

1. Ambasada **Stokholm** ka blerë “Mercedes Benz E 200 BlueTEC SEDAN”, viti 2015, me nr. shasje EDD2120061B227993 me vlerën e inventarit 25,523 Euro. (sipas inventarit të dërguar me shkresën nr. 120, dt. 18.07.2017) *Ky automjet është blerë nga vetë ambasada e Stokholmit dhe jo sipas ofertës fituese me koncensionarin “Mercedes Benz” Motoria srl Bari prej 32,400 Euro.*

2. Përfaqësia **Bari** ka blerë dy automjete:

- “Mercedes Benz, E205 Classe C – Limousine C 200 BlueTEC Automatic C”, viti 2015, me nr. shasje EDD2050371R075245 me vlerën e inventarit 32,400 Euro, me targa CC0029AA. Kontrata dt. 30.04.2015 me koncensionarin “Mercedes Benz” Motoria srl firmosur nga përfaqësuesi Konsullatës Bari, modeli “Mercedes Benz, Classe E Berlina E 200 Blue TEC”.

- “Mercedes Benz, Classe E Berlina E 200 Blue TEC” viti 2015 me nr. shasje EDD2120061B234966 me vlerën e inventarit 32,400 Euro, me targa CC0030AA. Kontrata dt. 30.04.2015 me koncensionarin “Mercedes Benz” Motoria srl firmosur nga përfaqësuesi Konsullatës Bari, modeli “Mercedes Benz, E205 Classe C – Limousine C 200 BlueTEC Automatic”. *Si shikohet edhe nga kontrata e mësipërme blerja për modelin “Mercedes Benz, E205 Classe C – Limousine C 200 BlueTEC Automatic”, nuk është në përputhje me specifikimet e ofertës fituese dhe urdhërit e Sekretarit të përgjithshëm nr. 92, dt. 14.04.2015. Kontrata me koncensionarin duhej të lidhej për modelin “Mercedes Benz, Classe E Berlina E 200 Blue TEC”.*

- Në memorandumun e datës 19.03.2015 e miratuar nga Ministri rezulton se në përfaqësitë që do të pajisen me automjete figuron edhe përfaqësia e Shqipërisë në Sofje, e cila nuk rezulton të jetë pajisur.

- Me miratimin e memorandumit të mësipërm nga MPJ janë marrë të drejtat e përfaqësive diplomatike dhe konsullore për të kryer vetë procedurat e prokurimeve. Gjithashtu nuk u paraqit ndonjë dokument ku të jenë përcaktuar rregullat që do të ndiqen nga përfaqësitë për procedurat e blerjes së automjeteve. Sa më lart është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 28, dt. 14.01.2015, i ndryshuar, nën pika 1.3 “Përfundimisht, lejohen përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, të akredituara jashtë vendit, që procedurat për blerje automjetesh ti realizojë vetë, sipas rregullave të tyre të brendshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III/5, faqe 47-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi

Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ambasada Paris të merren masat për arkëtimin e vlerës prej 781,64 Euro si diferencë midis fondit limit të miratuar, Oferta fituese 31,548 Euro dhe vlerës së blerjes sipas inventarit prej 32,329.64 Euro.

- Të merren masat për plotësimin e dosjeve pranë Ministrisë me dokumentacionin përkatës për blerjet e automjeteve nga përfaqësitë jashtë shtetit për vlerat sipas Urdhër Shpenzimit nr. 139, dt. 21.10.2014.

- Nga Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financë të merren masat që likuidimet nga Përfaqësitë jashtë shtetit për shpenzimet e tyre të kryhen nga llogaritë përkatëse të çelura sipas transfertave dhe natyrës së shpenzimit buxhetore.

- Me miratimin e memorandumit për kryerjen nga MEPJ e procedurave të blerjes së automjeteve janë marrë të drejtat e përfaqësive diplomatike dhe konsullore për të kryer vetë procedurat e prokurimeve sipas VKM nr. 28, dt. 14.01.2015.

- Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Përfaqësitë Diplommatike të merren masat për të përcaktuar rregullat që do të ndiqen nga përfaqësitë për procedurat e blerjes së automjeteve. Sipas përcaktimit të VKM nr. 28, dt. 14.01.2015, i ndryshuar, nën pika 1.3 “Përjashtimisht, lejohen përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, të akredituara jashtë vendit, që procedurat për blerje automjetesh ti realizojë vetë, sipas rregullave të tyre të brendshme”.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Në Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (AK), Njësia e Prokurimit (NJP) nuk ka funksionuar më vete në përbërje të strukturës organike, por gjatë vitit, si anëtar të NJP-ve, caktohen punonjës të ndryshëm, madje duke aktivizuar me pagesë edhe persona të tretë nga jashtë AK. Në këtë AK, ka zhvillime tenderash në një numër të konsiderueshëm dhe me procedura të ndryshme, duke përfshirë edhe tenderat e zhvilluar për blerje e shërbime të vogla si dhe ato të karakterit sekret. NJP-ja ka shumë përgjegjësi sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi. Nga NJP-të këto detyra nuk janë realizuar të gjitha dhe mangësitë e shkeljet e konstatuara, mund të ishin shmangur, shumica prej tyre, nëse NJP-ja do të funksiononte si strukturë më vete, si dhe po të ishin kryer edhe trajnimet e nevojshme pranë APP-së. (Më hollësisht trajtuar në pikën III/6, faqe 58-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi

Ministri, në varësi të burimeve njerëzore, që ka në dispozicion të shikojë mundësinë, për të ngritur funksionimin e strukturës së posaçme të prokurimit publik, e kjo në zbatim të nenit 57 “Njësia e Prokurimit” të VKM nr. 914, datë 29/12/2014, me qëllim edhe të sigurimit të mirë përdorimit të fondeve publike dhe të uljes së shpenzimeve procedurale duke rritur eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik.

Menjëherë

4. AK, ka hartuar për periudhën objekt auditimi regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike sipas formatit të miratuar nga APP-ja dhe i ka dërguar zyrtarisht në APP-në, ku regjistrat e realizimeve janë plotësuar me mangësi, si: *vlerat e kontratave të lidhura dhe të realizuara janë raportuar pa tvsh-në; nuk janë raportuar disa tendera të zhvilluar e të realizuar gjatë viteve.* Mos kryerjet e këtyre veprimeve bien ndesh me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 9, pika 1 si dhe me udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit”, të dërguar çdo vit, pika 32 “Mbi limitet e angazhimit”.

Tenderat e pa raportuara në regjistrat e realizimit të prokurimeve janë si më poshtë:

i) “*tendera të klasifikuara*”, ku sipas pikës 6 të LPP trajton Kontratat sekrete, kontratat të cilat kërkojnë masa të veçanta sigurie dhe kontratat, që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit, vetëm për përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike, pra të procedurave të prokurimit;

ii) “*shtesat e kontratave*”, të llojit të procedurës “*me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës*”, që janë bërë në fillim të çdo viti (20%), si: blerjet e karburanteve, riparimet e automjeteve, blerjet e biletave (për vitin 2015), ruajta e objekteve, etj. të kësaj natyre, madje edhe tendera të zhvilluara rregullisht, si blerje kafe dhe çaji. (Më hollësisht trajtuar në pikën III/6, faqe 58-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi

Njësia e Prokurimit për të ardhmen të marrë të gjitha masat, që në regjistrin e realizimit të tenderave të raportojë vlerën e kontratave duke përfshirë vlerën e tvsh-së. Gjithashtu në

regjistrin e realizimit të tenderave të raportojë çdo tender të zhvilluar sipas procedurave përkatëse.

Në vijimësi

5. Nuk janë lënë gjurmë në asnjë tender se cili nga anëtarët e KVO-ve është specialist i fushës së objektit të tenderit të zhvilluar si dhe anëtarët për anëtarët e NJP-ve, nëse e kanë arsimin e lartë përkatës, siç përcakton rregullorja e prokurimit publik në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/6, faqe 58-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi

Titullari i AK të marri të gjitha masat, që në dosjet e tenderave të cilësojnë emrin e anëtarit të KVO-së si specialist i fushës së objektit të tenderit si dhe për anëtarët e NJP nëse janë më arsim të lartë.

Në vijimësi

6. Grupet e auditimit të brendshëm për rastet, kur kanë konstatuar mbi shpenzime të pa argumentuara dhe kanë fiksuar vlerat përkatëse si dëme ekonomike për buxhetin e shtetit, për punonjësit që nuk janë më në marrëdhënie pune me subjektin e audituar *(punonjësit e ambasadave dhe konsullatave kanë lëvizje të shpeshta nga një shtet në shtetin tjetër)* nuk njoftojnë më për arkëtimin e dëmit ekonomik të konstatuar, por e kanë bërë praktikë pune, që ia dërgojnë Drejtorisë Juridike dhe Drejtorisë Ekonomike pranë MPJ. Për këto të tilla detyrime nuk janë bërë programe verifikimi siç programohen zbatimet e rekomandimeve të tjera. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/7, faqe 85-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim

Drejtoria e Auditit të Brendshëm të bëjë verifikimet e nevojshme herë pas here duke i programuar edhe në planet vjetore të auditimit dhe të nxjerrë përgjegjësinë për personat përkatës të dy drejtorive në rast se nuk është bërë ndonjë përpjekje për arkëtimin e dëmeve ekonomike.

Në vijimësi

7. Në auditime e kryer nga audituesit e brendshëm, të veprimtarisë financiare së përhershme të RSH-së në NATO, është konstatuar marrja me qira e tre apartamenteve, të cilat nuk janë më në përdorim nga përfaqësia, por ka mbetur e bllokuar shuma e vlerës së ngurtësuar prej **5,640** euro. Nga Përfaqësia e RSH në NATO dhe Misioni i RSH pranë BE nuk u janë vënë në dispozicion dokumentacioni i plotë për mënyrën e zgjidhjes së këtyre kontratave dhe detyrimet, që kanë mbetur pa shlyer apo arsyen e bllokimit të shumave të ngurtësuar. Nuk ka rezultuar që të ketë një korrespondencë zyrtare midis përfaqësies së RSH-së në NATO dhe MPJ për këtë çështje. Për këtë nga grupit të auditimit të brendshëm është lënë Rekomandoj: *“që përfaqësia e përhershme e RSH në NATO në bashkëpunim me ambasadën e RSH në Mbretërinë e Belgjikës dhe misioni i përhershëm i RSH pranë Bashkimit Evropian të ngrenë një grup pune për sqarimin e problematikave të kësaj çështje duke shkëmbyer informacionin e nevojshëm. Ky grup duhet të përgatisë dhe të dërgojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorisë së Programimit Buxhetor dhe Financës dhe Drejtorisë së Auditimit në MPJ informacion të hollësishëm dhe masat e nevojshme që do të merren për zgjidhjen e kësaj çështje”*. Në fakt audituesit duhej ta kishin audituar në vend këtë çështje duke i propozuar titullarit të ministrisë për një shtyrje afati verifikimi dhe kjo çështje duhej të ishte mbyllur përfundimisht rezultatit konkretë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/7, faqe 85-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim

Drejtoria e Auditimit të iniciojë pranë ministrit një mision auditimi për të bërë verifikimet e nevojshme dhe nxjerrjen e konkluzioneve deri në saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së ngurtësuar, duke vënien para përgjegjesisë punonjësit përkatës,.

Brenda datës 30 Tetor 2017

8. Në auditimin e kryer nga audituesit e brendshëm të MPJ, të veprimtarisë financiare së Misionit të RSH pranë OKB-së dhe aktivitetit të Konsullatës së RSH në Nju-Jork (*N.Y-e mbyllur*), ka konstatuar si gjetje pagim penaliteti për objekt qiraje, të vlerës prej **12,000** USD, të një godine, që kishte administruar konsullata. Kontrata e lidhur që në fillim vitit 2006 nga z. J., i cili aktualisht është në marrëdhënie pune me MPJ, është lidhur me gabime e risk të lartë, si pa shënuar afatin përkatës, dhe më vonë me një kontratë e rilidhur në Mars 2013 nga z. D. M. (aktualisht i larguar nga MPJ) nuk është bërë rishikimi apo ndryshimi përkatës i kushteve të kontratës. Pra vlera e ngurtësuar është dëm ekonomik për shtetin pasi apartamenti nuk përdoret më dhe misioni është mbyllur.

Audituesit këtë vlerë duhej ta kishte konsideruar dëm ekonomik, duke ja ngarkuar përgjegjësinë lidhësit të parë të kontratës si dhe punonjësit tjetër që ka rilidhur kontratën pa asnjë lloj ndryshimi.

Rekomandoj i lënë nga DAB, që kontratat për të ardhmen duhet të lidhen pasi të jetë marrë miratimi juridik më parë nga MPJ, nuk i shërben efektivitetit ekonomik të vlerave të përdorura. (*Më hollësisht trajtuar në pikën III/7, faqe 85-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim

Drejtoria e Auditimit të iniciojë ministrin për të kryer një mision auditimi për të bërë verifikimet e nevojshme dhe nxjerrjen e konkluzioneve, vënien para përgjegjesisë të personave përgjegjës, deri në arkëtimin e vlerës si pagim penaliteti, nqse nuk ka argumentim dokumentar.

Menjëherë

9. Në auditimin e kryer nga audituesit e brendshëm, për veprimtarisë financiare të Ambasadës së RSH-së, në Ankara-Turqi, janë konstatuar mjaft mangësi e shkelje në kuadrin e zbatimit të projektit të Qendrës Kulturore Shqiptare (QKSH) në Ankara, në zbatimin e ligjin nr. 7982, datë 21/12/1994 “*Për sponsorizimet*”.

MPJ për këtë auditim ka bashkëpunuar me APP-në si dhe Inspektimin Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave, ku kjo e fundit i ka kthyer përgjigje që kemi të bëjmë me dëme ekonomik në vlerën prej **4,210.34** EURO dhe **3,018.6** lira turke, nga financimi i bërë nga QKSH-ja në vlerën prej **20,125** EURO për 3 vite, sipas nenit 5 të memorandumit. Në materialet e auditimit cilësohen edhe shpenzime të tjera të kryer nga ky projekt për shpërblime punonjësish të ambasadës pa marrë më parë miratimin e MPJ. (*Më hollësisht trajtuar në pikën III/7, faqe 85-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimet

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, materialin e audituar për veprimtarinë financiare të Ambasadës së RSH-së, në Ankara-Turqi, në kuadrin e zbatimit të projektit të Qendrës Kulturore Shqiptare në Ankara, ta dërgojë pranë organeve të prokurorisë për vlerësim të elementeve penale.

Brenda vitit 2018

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Dëmi ekonomik i shkaktuar është në shumën **16,928,125** lekë dhe **150** EURO për të cilin kërkohet të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i saj, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Me anë të Memorandumit Nr. 454, datë 30.01.2014 të cilit i janë bashkëlidhur vendimet e ish Sekretarit të Përgjithshëm, janë kaluar në listë pritje punonjësit të cilëve u është prekur

vendi i punës si pasojë e ristrukturimit të institucionit në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 227, datë 02.12.2013 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MPJ”.

Nga auditimi i listë pagesave dhe nëpunësve të cilët trajtohen me statusin e nëpunësit civil u konstatua se për periudhën 01.01.2014 deri në 24.02.2015 kanë përfituar nga lista e pritjes 44 punonjës dhe ish punonjës të Ministrisë së Punëve të Jashtme sipas listë pagesave të deklaruara në shumën 22,419,502 lekë bruto, dhe neto në vlerën 17,851,033 lekë.

Në nenin 50 të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 për sistemimin e punonjësve në vende vakante është përcaktuar se ... Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori.

Transferimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet me precedencë, sipas kësaj renditjeje: a) në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; b) në institucionin, me të cilin institucioni është shkëputur apo bashkuar, në një nga institucionet, në të cilat institucioni është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; c) në institucionet e varësisë së institucionit të ristrukturuar; ç) në një institucion tjetër të shërbimit civil... VKM nr. 171, datë 26.3.2014, Kreu III.

Në Ligjin 152/2013, datë 30.5.2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, konstatohet se termi “Listë pritje”, nuk ekziston. Nën këtë arsyetim pagesat e kryera nga MPJ për punonjësit në “Listë pritje” është në kundërshtim me ligjin e mësipërm dhe vlera prej 15,833,657 lekë (Mars 2014 deri mars 2015) përbën dëm ekonomik për Institucionin dhe duhet të arkëtohet. (Më hollësisht trajtuar në pikën III/3, faqe 21-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim

Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **15,833,657** lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, të përfituar padrejtësisht për shkak të trajtimit të tyre si punonjës në “listë pritje” nga 44 punonjës dhe ish punonjës të Ministrisë së Punëve të Jashtme sipas listë pagesave të deklaruara (*bashkëlidhur*) për vitin 2014 dhe 2015 në kundërshtim me Ligjin 152/2013, datë 30.5.2013 “Për statusin e nëpunësit civil”.

Menjëherë

2. Sipas Urdhrit të Ministrit të Punëve të Jashtme nr. 22, dt. 25.01.2016, anëtarët e Komisionit të posaçëm të shpronësimit të një pjese të pasurisë “Ofiçina e Automjeteve Tiranë” kanë përfituar në mënyrë të pa drejtë vlerën prej 800,000 lekë, vlerë e destinuar për shpenzimet procedurale të shoqëruara me dokumentet që vërtetojnë shpenzimet e procedurës së shpronësimit në kundërshtim me VKM nr. 1044, dt. 16.12.2015 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës “Mbi reciprocitetin e godinave ku akomodohen përfaqësia diplomatike e Republikës Popullore të Kinës Tiranë” nënshkruar më 10.04.1960”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III/3, faqe 45-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim

Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **800,000** lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, të përfituar padrejtësisht si shpërblim në kundërshtim me VKM nr. 1044, dt. 16.12.2015 nga anëtarët e komisionit:

Z. S. B., kryetar, në vlerën prej 140,000 lekë.

Z. Q. Q., anëtar, në vlerën prej 140,000 lekë.

Znj. E. H., anëtare, në vlerën prej 140,000 lekë.

Z. B. E., anëtar, në vlerën prej 140,000 lekë.

Z. S.G., anëtar, në vlerën prej 140,000 lekë.

Znj. F. M., Sekretaria teknike, në vlerën prej 50,000 lekë.

Znj. E. S. punonjëse e ALUIZNI-t në vlerën prej 50,000 lekë.

Menjëherë

3. Me mandat pagesën nr. 156, datë 11.05.2015 është paguar eksperti i jashtëm, Drejtor i Studimeve Evropiane në Departamentin e Universitetit Graz Austri, në shumën prej 1,000 euro, sipas urdhrit nr. 103, datë 17.04.2015 nënshkruar nga ish Sekretar i përgjithshëm i MPJ, me objekt shlyerjen e pagesës ndaj z. F. B.: *“Hartimin e një artikulli analitik për konferencën “Freedom of Expression and Media”, pa ndalur tatimin në burim në masën 15 % mbi të ardhurat në shumën prej 150 Euro, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar me ligjin nr. 9716, datë 16.04.2007, neni 4, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. (Nuk ka marrëveshje me shtetin austriak për përjashtimin e taksimit të dyfishtë). (Më hollësisht trajtuar në pikën III/5, faqe 54-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim

Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të merren masat për nxjerrjen e përgjegjësisë dhe për arkëtimin e shumën prej **150** euro, për sa përfituar padrejtësisht nga F.B., Drejtor i Studimeve Evropiane në Departamentin e Universitetit Graz Austri.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE.

1. Në lidhje me shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet titullarit të institucionit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore sipas përgjegjësisë individuale të drejtuesve:

Z. Q. Q., ish Sekretari i Përgjithshëm,

Znj. B. K., Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse,

Znj. I. D., Drejtori i Planifikimit të Buxhetit dhe Financës;

Menjëherë

D. TË TJERA

1. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2018.

2. Për rekomandimet e pazbatuara që lidhen me shpërblimin e dëmeve, kërkohet edhe njëherë **që, brenda muajit shtator 2018**, të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të bërë të mundur kthimin e këtyre fondeve buxhetore në arkën e shtetit. Nëse, në përfundim të këtij afati, këto rekomandime **do të rezultojnë përsëri të pazbatuar**, KLSH në zbatim të nenit 15 germa “gj” të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, do të bëjë për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, **kallëzim penal në Organet e Prokurorisë** si dhe do të njoftoj Komisionin Parlamentar për Ekonomin dhe Financat.

3. Për rekomandimet e lëna me shkresën nr.509, datë,06.10.2017, të Kryetrit të KLSH, për procedurat e prokurimeve të klasifikuara “Sekret Shtetëror”, Ministria për Evropën dhe Punëve e Jashtëme, **brenda muajit shtator 2018**, të dërgoi informacion në KLSH, në lidhje ecurine dhe nivelin e zbatimit të tyre.

6.AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Nga auditimi i ushtruar mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH, dërguar me shkresën nr.1192/18, datë 09.08.2017, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe bazuar në praktikat dokumentare të paraqitura nga stafi drejtues i Institucionit të ARRSH, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Autoriteti Rrugor Shqiptar ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës me nr. 1192/18, datë 09.08.2017, ka dërguar në KLSH planin e zbatimit të masave me Nr.6464/3 Prot., datë 22.08.2017.

Në zbatim të nenin 30 pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” për *Respektimin e afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014.*

- Nga auditimi rezultoi se, ARRSH nuk ka dërguar informacion për punën e bërë brenda afatit 6 mujor lidhur me zbatimin e rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 7 **masa organizative**, të pranuar dhe të zbatuara dhe një në proces zbatimi.
- b. Masa për shpërblim dëmi janë lënë 7 **rekomandime** për shumën 41,025,862 lekë, janë pranuar dhe janë në proces zbatimi.
- c. Rekomanduar 3 masa disiplinore, nga të cilat 1 një është zbatuar dhe 2 të pa zbatuara.

Në përfundim **rikërkojmë** nga Autoriteti Rrugor Shtetëror zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr.1192/18, datë 09.08.2017, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, dhe në proces zbatimi si më poshtë:

A. MASA DISIPLINORE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt konstatimet dhe procesverbalet përkatës, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

A. I. Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe neni 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor për shërbimin civil” i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e **masave disiplinore nga “ulje në detyrë” deri në “largim nga detyra”**, për personat si më poshtë:

1. Z. A. Q. me detyrë Zv/Drejtor i Përgjithshëm njëkohësisht i Këshillit Teknik,

2. Z. E. H. me detyrë Zv/Drejtor i Përgjithshëm njëkohësisht Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të projekteve të Huaja të Brendshme dhe Shpronësimeve,

3. Z. E. H. me detyrë Drejtor i Planifikimit të Buxhetit,

4. Z. A. A. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik,

5. Z. S. T. me detyrë inxhinier,

6. Z. A. Z. me detyrë inxhinier,

7. Z. A. M. me detyrë inxhinier

8. Zj. A. A. me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Projekteve Teknike, në cilësinë e anëtarëve të KT të ARRSH, për shkak se:

Në tenderin me objekt *“Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë loti 3”* *“Shtesë kontrate”* me vlerë e plotë 208,198,211 lekë:

Këshilli Teknik (KT), ka pranuar/lejuar:

- Ndryshime thelbësore të projektit të paktën për urën e Sulovës (mbi lumin Vjosë) dhe rritjen me 208,198,680 lekë, ose mbi 18 për qind të vlerës së kontratës bazë nëpërmjet *‘Shtesës së punimeve’*,

- Ndryshimin e projektit për segmentin Gostimë – Mollas, saktësisht *“Ura e re e Sulovës”* hartuar (firmosur dhe vulosur) nga BOE *“.....”* sh.p.k, në kundërshtim me pikën 7 të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 13.5.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*.

- Nuk ka leje ndërtimi, nuk është kërkuar/bërë oponenta teknike e projektzbatimit të urës së re Sulovë, në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar në të cilin është përcaktuar se ... *Oponenta teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha lejet e ndërtimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 milion lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve.*

9. Z. S. P. me detyrë inxhinier,

10. Zj. L. S. me detyrë inxhinier,

11. Zj. E. Z. me detyrë inxhinier,

në cilësinë e anëtarëve të grupit të hartuesve të *“Termave të referencës”*, për shkak se në tenderin me objekt *“Studim Projektim plotësim By Pass Shkodër si pjesë e korridorit Veri Jug dhe lidhja me qytetin”* me vlerë 106,409 mijë lekë:

Veç sa më sipër grupi i hartimit të “Termave të referencës” është përgjegjës pasi:

- ka kërkuar studim fizibiliteti të thelluar si edhe plan biznesi, në kundërshtim me germën *“a”*, të pikës 1, të nenit 4 *“Fusha e Zbatimit ...”*, të Ligjit 125/2013 *“Për Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Priva”* (i ndryshuar), duke e shoqëruar shërbimin e kërkuar me kosto dhe kohë shtesë për kryerjen e tij (nuk është kompetencë e ARRSH).

Shënim: Në cilësinë e anëtarit të grupit të hartuesve të *“Termave të referencës”*, në tenderin me objekt *“Studim Projektim plotësim By Pass Shkodër si pjesë e korridorit Veri Jug dhe lidhja me qytetin”* me vlerë 106,409 mijë lekë, është dhe **zj. A. A.** me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Projekteve Teknike, për të cilën është propozuar masë në pikën D.I.

12. Z. D. F. me detyrë jurist, në cilësinë e kryetarit,

13. Zj. A. H. me detyrë juriste,

në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkak se në tenderin me objekt *“Studim Projektim plotësim By Pass Shkodër si pjesë e korridorit Veri Jug dhe lidhja me qytetin”* me vlerë 106,409 mijë lekë:

- Kanë përdorur standard të dyfishtë (diskriminues) në vlerësimin/kualifikimin e OE për kriterin kualifikues *“Punë të ngjashme”*.

Komisioni i vlerësimit të ofertave, operatorin ekonomik që ka paraqitur *“Punë të ngjashme”* më vlerë më të lartë se dy të tjerët (por që në fund të procedurës së tenderit, nuk ka rezultuar fitues) e ka vlerësuar me pikë, më pak se dy operatorët ekonomikë e tjerë, vlera e *“Punimeve të ngjashme”* të të cilëve është më e ulët, ndërkohë që minimalisht KVO duhet t'i vlerësonte me të njëjtin sasi pikësh.

Kjo diferencë në vlerësim, ka ndikuar drejtpërdrejtë në shpalljen fitues të OE që ka *“punime të ngjashme”* në vlerë më të ulët, por që KVO i ka vlerësuar me pikë më shumë.

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, date 20/11/2006 *“Për Prokurimin Publik”* (i ndryshuar), germën d), të pikës 2, të neni 1, *“Qëllimi i Ligjit”*.

- Kanë gabuar në vlerësimin me pikë të kriterit “Metodologjia”, e cila vlerësohet me 20 deri në 50 pikë.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se njëri prej OE nga tre gjithsej, nuk ka paraqitur projektide, ose ndonjë variant të mundshëm për realizimin e shërbimit, në funksion të “Përqasjes teknike”, “Metodologjia, plani i punës, aftësia organizative” (term i përdorur në vlerësimin e kriterëve) të kërkuar me DST.

Pavarësisht sa më sipër, ky OE, nga KVO për këtë kriter është vlerësuar me më shumë pikë dhe është shpallur fitues, kurse dy OE të tjerë pjesëmarrës në tender që e kanë plotësuar këtë kriter, janë vlerësuar me aq pikë (më pak), sa të mos dalin fitues të tenderit.

Po këtu, OE i shpallur fitues, ka paraqitur për vlerësim të njëjtin dokument “Metodologjia, plani i punës, aftësia organizative” si dhe relacion shpjegues, si atë të njërit prej OE (jo fitues) të vlerësuar me më pak pikë nga KVO.

Në këtë rast KVO ka vepruar në kundërshtim me nenin 65 “Ndërhyrja në ofertë” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” të cilin është përcaktuar se ... *Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën kontratë, në çfarëdo lloji kapaciteti. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.*

Normalisht KVO duhet të s’kualifikonte të dy OE, njëri prej të cilëve është kualifikuar dhe është shpallur fitues.

Menjëherë

B.TË TJERA

1.Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2018.

2. Për rekomandimet e pazbatuara që lidhen me masat disiplinore, kërkojmë edhe njëherë që, ***brenda muajit shtator 2018***, Drejtori i ARRSH, të vlerësojë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të filloi procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “ulje në detyrë” deri në “largim nga detyra”.

Nëse, në përfundim të këtij afati, këto rekomandime ***do të rezultojnë përsëri të pazbatuar***, KLSH do të bëjë me dije Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe në zbatim të nenit 15 germa “gj” të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, do të bëjë për Drejtorin e Autoritetit Shtetëror të Rrugëve, ***kallëzim penal në Organet e Prokurorisë.***

7. MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGISË (ish Ministrinë e Zhvillimit Urban, ish Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës. ish Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë.)

Në përfundim të Auditimit me shkresën nr. 265/7, dt. 27.06.2017 sipas Vendimin nr. 676, datë 24.06.2017 të Kryetarit të KLSH-së është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar në ish Ministrinë e Zhvillimit Urban.

Me shkresën nr. 1189/13 datë. 228.04.2017 sipas Vendimin nr. 35, datë 28.04.2017 të Kryetarit të KLSH-së është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar në ish Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

Me shkresën nr. 266/38, datë. 12.9.2017, sipas Vendimin nr. 111, datë 12.9.2017 të Kryetarit të KLSH-së është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar në ish Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë.

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ish Ministria e Zhvillimit Urban, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani, me shkresën nr. 3813/1, datë 18.07.2017, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara. Ish Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe ish Ministria e Energjitikës dhe Industrisë nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH brenda 20 ditëve nga marrja dijani.

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ish Ministria e Zhvillimit Urban, ish Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës si dhe ish Ministria e Energjitikës dhe Industrisë nuk i kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 75 rekomandime gjithsej, nga këto: 8 për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore, 45 masa organizative, 13 masa zhdëmtimi, 2 masa administrative si dhe për përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike 7 rekomandime .

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

*i. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore dhe nënligjore** 8 rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht 8 rekomandime, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 0 rekomandime, në proces zbatimi 5 rekomandime dhe të pa zbatuar 3 rekomandime.*

*j. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 45 **masa organizative**, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 45 rekomandime, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 15 rekomandime, në proces zbatimi 14 rekomandime, dhe të pa zbatuar 16 rekomandime.*

*k. Janë rekomanduar 13 **masa zhdëmtimi**, nga të cilat janë pranuar plotësisht 13 rekomandime, nga të pranuarat janë të pa zbatuar 13 rekomandime.*

l. Janë rekomanduar 2 masa administrative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 2 rekomandime, nga të pranuarat janë në proces zbatimi 2 rekomandime

*m. Janë rekomanduar 7 **masa për përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike**, nga të cilat janë pranuar plotësisht 2, nga të pranuarat janë në proces zbatimi 2 rekomandime dhe të pa zbatuar 5 rekomandime.*

Në përfundim **rikërkojmë** nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 305/12, datë 8.11.2017, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara si më poshtë:

A. Ish- Ministria e Energjitikës dhe Industrisë

Gjetja 1.

Në tenderin për “Rehabilitimin i zonës të ish-Metalurgjikut Elbasan (“Ndërmarrjes së Prodhimit të Çelikeve”, “Uzinës 12 & Ni-Co” dhe “Kombinatit Energjetik”, me fond limit 229,572, 873 lekë të realizuar në vitin 2015 është paraqitur vetëm operatori “...”, i cili është shpallur edhe fitues me vlerë oferte 222,502,905 lekë, të ndarë: rehabilitimi i “Ndërmarrjes së Prodhimit të Çelikeve” në vlerën 95,631,938 lekë, rehabilitimi i “Uzinës 12 & Ni-Co”, në vlerën 77,613,314 lekë dhe për rehabilitimin i “Kombinatit Energjetik” në vlerën 49,257,650 lekë. Tre kontratat e zbatimit me këto ndërmarrje janë lidhur në datën 09.12.2015 dhe kontrata e mbikëqyrësit të punimeve është lidhur në datën 14.12.2015. Punimet për të tre kontratat kanë filluar në datën 14.12.2015. Mbas rreth një jave nga fillimi i punimeve, janë likuiduar në favor të sipërmarrësit nga të tre këto ndërmarrje situacione me vlerë rreth 20 milion secila në total rreth 60 milion (që i përket financimit të vitit 2015).

Mirëpo zërat dhe volumet e këtyre situacioneve nuk përputhen me zërat dhe volumet e preventivit të ofertës fituese. Sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi me miratimin e investitorit (të drejtorëve të ndërmarrjeve) kanë ndryshuar pothuajse rreth 80-90% të volumeve dhe çmimeve të ofertës fituese për të tre këto objekte, në kundërshtim me LPP dhe me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të cilat nuk lejojnë ndryshim e çmimeve të preventivit fitues përgjatë zbatimit të kontratës. Ndryshimi është bërë në ulje të ndjeshme të volumeve dhe në rritje të ndjeshme të çmimeve të ofertës. Pra, nuk janë shtuar zëra të rinj pune që nuk ishin parashikuar në preventivin e projektuesit, por janë ulur volumet e këtyre zërave dhe për të balancuar vlerën e kontratës (ofertës fituese) të kursyer nga ulja e volumeve, janë ndryshuar çmimet e ofertës duke i rritur ndjeshëm ato. Kështu, kanë ndryshuar: zëri “prishje mure betoni” me çmimi të ofertës fituese 1,000 lekë për m³, është rritur në 3,078 lekë për m³ dhe zëri “prishje kolona trarë beton/arme” me çmimi të ofertës fituese 1,915 lekë për m³, është rritur në 6,356 lekë për m³. Në fakt, në zbatim të LPP, mbas rishikimit të zërave dhe volumeve të preventivit, të llogaritura me çmimet e ofertës fituese, vlera e punimeve për dy objekte duhet të ishte në shumën 75,661,536.42 lekë (36,349,639.92 lekë+39,311,896.5) lekë dhe jo në shumën 173,242,249 lekë (95,631,939.12 lekë+77,610,309.90 lekë), sa është llogaritur nga mbikëqyrësi, miratuar nga investitori, zbatuar nga sipërmarrësi dhe likuiduar në favor të tij, nëpërmjet dy ndërmarrjeve nga buxheti i MEI.

Nga kjo shkelje i është shkaktuar buxheti të shtetit dëm ekonomik në vlerën 97,580,712 lekë, përkatësisht, për rehabilitimin e “Ndërmarrjes së Prodhimit të Çeliqueve” në vlerën 59,282,299 lekë dhe për rehabilitimi i “Uzinës 12 & Ni-Co” në vlerën 38,298,413.4 lekë

Për sa më sipër është rekomanduar:

1.1. Ministria e Energjisë dhe Industrisë në bashkëpunim me Ndërmarrjen e Prodhimit të Çeliqueve, Elbasan, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për ndryshimin e preventivit dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në ***vlerën 59,282,299 lekë***, nga shoqëria përfituese “Viktoria Invest”.

Për sa më sipër është rekomanduar:

1.2. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me Uzinën 12 & Ni-Co, Elbasan, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për ndryshimin e preventivit dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në ***vlerën 38,298,413.4 lekë***, nga shoqëria përfituese “...”.

Gjetja 2.

Në procedurat e prokurimit për “Rikonstruksionin i magazinës industriale 2 katesh të (ish-NFIM) Balëz, Elbasan”. Kjo procedurë është realizuar me dy faza, faza e parë është realizuar në vitin 2015 me fond limit 15,669,805 lekë dhe fazës e dyte është realizuar në vitin 2016 me fond limit 9,991,868 lekë. Në të dy procedurat u konstatuan shkelje të LPP, si më poshtë:

-Në DT të dy procedurave është vendosur dhe kërkuar që, ofertuesit duhet të paraqesë licencë nga Ministria e Mjedisit për “Grumbullim, transportim, ruajtje e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme”. Kjo kërkesë është vendosur diskriminuese dhe në kundërshtim me LPP sepse në projektin e zbatimit dhe preventivat e zbatimit të projektuesit, nuk është parashikuar që të behet transporti i mbetjeve kimike, por është parashikuar të bëhet transport i mbetje të ndërtimit, pra grumbullimi, rruajtje, transportime i mbetjeve të rrezikshme nuk kanë lidhje me kontratat e ndërtimit. Vendosja e këtij kriteri është bërë shkak për s’kualifikime të padrejta të operatorëve që kanë konkurruar në të dy procedurat, sepse tre nga katër operatorët pjesëmarrës në këto procedurë kanë paraqitur ofertën më të ulët në tender se operatori fitues, por janë s’kualifikuar pikërisht se nuk plotësojnë këtë kriter. Si pasojë e kësaj shkeljeve janë përdorur fonde pa efektivitet dhe ekonomikitet për “Rikonstruksionin i magazinës industriale 2 katesh” të realizuar në vitin 2015, në vlerën ***6,312,849.6 lekë*** dhe për “Rikonstruksionin i magazinës industriale 2 katesh” të realizuar në vitin 2016, në ***vlerën 3,159,592 lekë***.

Për këtë rekomandoj:

MEI të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike **në vlerën 9,472,441.6 lekë.**

Menjëherë

Gjetje 3. Në procedurën e prokurimit për “Implementimi i Sistemit Informatik të MEI” të realizuar në vitin në vitin 2016, me fondi limit **22,483,333 lekë**, janë konstatuar shkelje në përdorimin e fondeve pa efektivitet dhe ekonomikitet, që shkojnë në vlerën 9,382,800 lekë. Në këtë procedurë është s`kualifikuar një operatorë me ofertë ekonomike me të ulët se fituesi, në vlerën 9,382,800 lekë. S`kualifikimi është bërë, sepse në dokumentacionin e paraqitur për plotësimin e kritereve të veçanta dhe specifikimeve teknike kishte disa mangësi. KVO, duhej ti kërkonte këtij operatori sqarime për këto mangësi, dhe mbas shqyrtimit të tyre, nëse bindej duhej ti konsideronte këto mangësi devijime të vogla dhe ta kualifikonte dhe ta shpallte fitues këtë operator. Si pasojë e kësaj shkeljeve janë përdorur fonde pa efektivitet dhe ekonomikitet, në vlerën 9,382,800 lekë.

Për këtë rekomandoj:

MEI të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike **në vlerën 9,382,800 lekë.**

Menjëherë

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë propozuar 2 (dy) masa administrative në lidhje mbi *Ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese* që është përmblytur nga ndërtimi i hidrocentraleve mbi lumin Devoll, të cilat janë në proces zbatimi.

Gjetja 1.

Për ndërtimin e rrugës zëvendësuese Banjë-Gramsh dhe Ura e Trashovicës:

1.1. Në datën 30.01.2014, DHP ka lidhur kontratën me JV “Italconsalt&Sgai” për hartimin e projektit të zbatimit të kësaj rruge, duke hedhur kështu, tërësisht poshtë projektin e hartuar në vitin 2013 nga ARRSH. Sipas urdhër-shpenzimeve të MEI deri në datën 31.01.2017 është paguar 1,829,000 Euro, nga 2,063,264 Euro të parashikuara për tu financuar. Meqenëse projekti i hartuar dhe i paguar nga ARRSH nuk është rishikuar nga DHP, por ka dalë tërësisht jashtë përdorimit, puna projektuese **në vlerën 388,225 Euro e paguar nga ARRSH përbënë dëm ekonomik për buxhetit e shtetit.**

Për këtë rekomandoj:

-Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të informoi Autoritetin Rrugor Shqiptarë dhe në bashkëpunim, të analizojnë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin e shkaktuar me pamundësi arkëtimi në **vlerën 388,225 Euro**, si pasojë e moszbatimit të projektit të zbatimit për ndërtimin e rrugës zëvendësuese “Banjë-Gramsh”.

Menjëherë

1.2. Në kundërshtim me shtesën nr. 3, të kontratës së koncesionit e miratuar me ligjit nr. 7, datë 15.02.2015, DHP nuk ka realizuar procedura konkurruese për përzgjedhjen e kontratës fituese për mbikëqyrjen e punimeve. Mbikëqyrja e punimeve për këto rruge është bërë nga vetë DHP nëpërmjet kontratave të punësimit individual dhe kosto e punës mbikëqyrëse për tu financiar nga MEI është llogaritur në vlerën 3,291,766 Euro, në kundërshtim me VKM nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Mbështetur në vlerën përfundimtare të punimeve prej 36,236,836 Euro, në zbatim të kësaj VKM, tarifa e mbikëqyrjes duhet të ishte në vlerën 152,416 Euro dhe jo 3,291,766 Euro, **pra kosto e mbikëqyrjes është rritur padrejtësisht në dëm të buxhetit të shteti për vlerën 3,139,350 Euro.**

(Theksojmë se, shpërblimi i punës projektuese dhe mbikëqyrëse deri në fund të vitit 2014 rregullohej me VKM nr.444, datë 05.09.1994 dhe më pas me VKM nr. 704, datë 29.10.2014. Këto VKM, nuk kane të bëjë me prokurimit publik dhe nuk kanë dalë në zbatim të ligjit për prokurimin publik, dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij apo të ndonjë akt ligjor

dhe nënligjor që mund të përcaktoj rregullat të tjera e prokurimit publik, të cilat sipas pikës 3.1, të shtesës nr.3, të kontratës së koncesionit të miratuar me ligjin nr. 7, datë 15.02.2015, nuk zbatohen nga Koncesionari në procesin e tenderimit të projektimit, ndërtimit, mbikëqyrjes ose shërbime të tjera ndihmëse në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese. Por, këto VKM, kanë dalë në zbatim të akteve ligjore që rregullojnë veprimtarinë e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit brenda vendit. Konkretisht kane dalë në zbatim të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”. Pra vlerat e kontratave të projektimit dhe të kontratave të mbikëqyrjes të financuara me fonde buxhetore do të llogariten sipas tarifave të përcaktuara në këto akte ligjore e nënligjore dhe mbi bazën e këtyre vlerave do të vijohej me përzgjedhjen e projektuesit dhe mbikëqyrësit nëpërmjet procedurave të tenderimit të realizuara sipas rregullave të vetë koncesionarit të përcaktuar në neni 3.1 të sipërcituar).

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me koncesionarin “DHP”, të analizojnë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin e shkaktuar me pamundësi arkëtimi në **vlerën 3,139,350 Euro.**

Menjëherë

2. Për ndërtimin e rrugës zëvendësuese Moglicë M03:

2.1. Sipas dokumenteve financiare të dërguara nga DHP në MEI për pagesat e punëve të kryera, kosto e kësaj rruge deri në 31.01.2017 ka shkuar 9,546,000 Euro. Në këtë vlerë, përfshihen edhe, vlera e projektimit në shumën 907,000 Euro, vlera e ndërtimit në shumën 6,750,000 Euro dhe vlera e mbikëqyrjes në shumën 743,829 Euro. Mbështetur në vlerën e ndërtimit prej 6,750,000 Euro, tarifa e projektimit në zbatim të VKM nr. 704, datë 29.10.2014 duhet të ishte në vlerë 186,309 Euro. Ndërsa në fakt, puna projektuese është parashikuar për tu financuar nga MEI në vlerën 907,000 Euro, ***pra kosto e punës projektuese është rritur padrejtësisht në dëm të buxhetit të shteti për vlerën 881,588 Euro.*** Po kështu, në kundërshtim me shtesën nr. 3, të kontratës së koncesionit e miratuar me ligjin nr. 7, datë 15.02.2015, DHP nuk ka realizuar procedura konkurruese për përzgjedhjen e kontratës fituese për mbikëqyrjen e punimeve. Mbikëqyrja e punimeve edhe për këtë rruge është bërë nga vetë DHP nëpërmjet kontratave të punësimit individual dhe shpërbliimi i punës mbikëqyrëse deri në datën 31.01.2017 është parashikuar për tu financuar në vlerën 743,829 Euro. Në zbatim të VKM nr. 704, datë 29.10.2014, mbështetur në vlerën e punimeve prej 6,750,000 Euro shpërbliimi i punës mbikëqyrëse duhet të ishte në vlerën 44,904 Euro, ***pra kosto e këtij shërbimi është rritur padrejtësisht në dëm të buxhetit të shtetit për vlerën 698,922 Euro .***

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me koncesionarin “DHP”, të analizojnë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin e shkaktuar me pamundësi arkëtimi në **vlerën 698, 922 Euro.**

Menjëherë

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë rekomanduar 3 (tre) masa për mos përdorimin me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike, nga të cilat janë pranuar nga subjekti, por ende janë të parealizuara.

Gjeta 1.

Për ndërtimin e rrugës zëvendësuese Moglicë M 15:

Për ndërtimin e rrugës Moglicë M 15, në datën **05.07.2013**, DHP ka lidhur një kontratë me kompaninë “...”. Kjo rruge sipas kësaj kontrate ishte parashikuar të ndërtohej me financimin e vetë të DHP, në vlerë fillestare prej 2,189,213.44 Euro. ***Kjo kontratë fillimisht nuk është miratuar dhe konfirmuar nga MEI dhe nga ARRSH.*** Mirëpo, pas dy vjetësh, me ligjin nr. 7, datë 15.02.2015, u përfshi që të financohej nga buxheti i shtetit, duke u rritur në vlerën 3,117,072 Euro dhe deri në 31.01.2017, kosto aktuale e kësaj rruge është rritur ***për 7,274,769 Euro.*** Në këtë vlerën përfshihet edhe tarifa e projektimit dhe e mbikëqyrjes në shumën 636,800 Euro. Financimi nga fondet buxhetore në favor të DHP të tarifës së projektimit

dhe mbikëqyrjes **në shumën 636,800 Euro, përbën** përdorim pa efektivitet dhe ekonomikitet të këtyre fondeve sepse, në shtesën nr.3, të kontratës së koncesionit të miratuar me ligjin nr. 7, datë 15.02.2015, nuk përcaktohet financimi i punës projektuese dhe i punës mbikëqyrëse, por vetëm vlera e ndërtimit.

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të analizojnë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike **në vlerën 636,800 Euro.**

Menjëherë

Gjetja 2.

Për ndërtimin e rrugës zëvendësuese Banjë-Gramsh dhe Ura e Trashovicës:

Fillimisht kosto e kësaj rruge sipas projektit të zbatimit ishte parashikuar për 30,196,554 Euro, e ndarë në dy kontrata (seksione), seksioni 3A “Banja pjesa lindore e luginës së Holtës me kosto 23,702,604.72 Euro dhe seksioni 3B “pjesa lindore e luginës së Holtës-Gramsh plus Urën e Trashovicës” me kosto 6,493,950 Euro. Nga DHP gjatë vitit 2014 para miratimit nga KM dhe Kuvendi të shtesës n. 3 të kontratës së koncesionit është realizuar procedura e tenderimit për ndërtimin e kësaj rruge. Fitues për ndërtimin e seksioni 3A rruga Banjë-Gramsh është shoqëria “Abstar” me të cilën është lidhur kontrata në datën 16.12.2014 me **vlerë 25,365,321.4 Euro**, dhe për ndërtimin e seksioni 3B, rruga Banjë-Gramsh përfshi edhe urën e Trashovicës është shoqëria “....” me të cilën është lidhur kontrata në datën 16.12.2014 me **vlerë 7,346,881.5 Euro**. Të dy kontratat fituese janë në vlerën 32,7712,202 Euro, pra më shumë për 2,515,648 Euro se, kosto e llogaritur nga projektuesi, para zhvillimit të procedurës së prokurimit. Kjo rritje është justifikuar se, në datën 10.12.2014, ARRSH nëpërmjet letrës me nr. 889/5, datë 10.12.2014, ka dërguar Vendimin e Këshillit Teknik nr. 66, datë 10.12.2014, për miratimin e projektit të zbatimit duke përfshirë kostot e parashikuara prej 30,200,000 Euro, **me shënimin në kllapa që, kjo shumë mund të rritet me 10% gjatë negociatave të tenderit për shkak të kohës së shkurtër që është planifikuar për ndërtim.** Miratimi dhe pranimi i kostos së ndërtimit në vlerën 32,7712,202 Euro, në emër të MEI është bërë nga zv. Ministri. Ky miratim nuk është bërë me shkresë zyrtare nga Ministria me numër protokolli dhe datë, në kthim të përgjigjes së shkresë së DHP nr.01579, datë 11.12.2014, por është nënshkruar në fund të kësaj shkrese me shënimin “Pranuar dhe miratuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë”.

Gjithashtu, gjatë zbatimit të punimeve deri në datën 31.01.2017, kosto aktuale e ndërtimit të rrugës është rritur përsëri në vlerën 36,236,836, ose 20% më shumë se, kosto së parashikuar në projektin e zbatimit (fondi limit). Së bashku me, vlerën e punës projektuese dhe mbikëqyrëse dhe disa kostove të tjera shtesë, kosto totale e investimit deri në datën 31.01.2017 për tu financuar **është 42,970,210 Euro**. Rritje e kostos, përveç rritjes së vlerës së ndërtimit, ka të bëjë me rritjen e vlerës së punës projektuese dhe punës mbikëqyrëse, tarifat e të cilave janë përcaktuar më të larta se, çmimet e tregut vendas, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Konkretisht:

Kosto e përfundimtarë e ndërtimit është në vlerën 36,236,836 Euro dhe mbështetur në këtë vlerë dhe bazuar në VKM nr. 444, datë 05.09.1994 “Për tarifat e studimit, drejtimit mbikëqyrjes dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit”, tarifa e projektimit duhet të ishte në vlerën 774,285 Euro. Ndërsa është parashikuar për tu financuar nga buxheti i shtetit në vlerën në vlerën 2,330,433 Euro, **pra në kundërshtim me këtë VKM kosto e punës projektuese është rritur padrejtësisht, duke bërë që fondet buxhetore në vlerën 1,556,148 Euro të** përdoren pa efektivitet dhe ekonomikitet.

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të analizojnë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në **vlerën 1,556,148 Euro.**

Menjëherë

3. Për ndërtimin e rrugës zëvendësuese Moglicë M03:

ARRSH ka miratuar projektin e zbatimit për ndërtimin e kësaj rruge me vlerë 7,016,494 Euro. Në muajin prill 2016 ka përfunduar tenderi për përzgjedhjen e kontraktorit. Sipas raportit të vlerësimit është shpallur fitues operatori “...” me ofertë 6,238,081 Euro, i dyti operatori “.....” me ofertë 6,218,516 Euro, i treti operatori “...” me ofertë 5,274,140 Euro. Ka dalë fitues kompania ...” edhe pse kishte çmimin e ofertës më të lartë se dy ofertues të tjerë, me arsyetimin se, ky ofertues ka përgatitje të mirë, në lidhje sigurimin e cilësisë dhe çështjet teknike. Këto cilësi i ka treguar gjatë zbatimit të punimeve si kontraktor i DHP në ndërtimin e rrugës Banjë-Gramsh (të sipërcituar). Por mbas 2 muajve, vetë DHP e ka rivlerësuar ofertën e kësaj kompanie dhe ka ngritur pretendimin se, gjatë 5-6 muajve të fundit është vënë re që kompania është mbrapa me ndërtimin e rrugës Banjë-Gramsh dhe cilësia e punimeve ka rënë. Nisur nga kjo, ka renditur të parin operatorin “.....” dhe i ka rekomanduar MEI lidhjen e kontratës së zbatimit me këtë kompani. Por, më pas me miratim të Ministrisë kontrata është lidhur përsëri me kompaninë “...”. **Pra, duket qartazi formaliteti, fiktiviteti dhe subjektivizmi në vlerësimin dhe zgjedhjes e kompanisë fituese, sepse: DHP nuk bëri vlerësim negativ për kompaninë “Albstar” gjatë vlerësimit të ofertave në muajin prill, kohë që kjo kompani kishte shfaqur probleme me afatin dhe cilësinë e ndërtimit të rrugës Banjë-Gramsh, por ofertën e kësaj kompanie e vlerësoi si më të suksesshmen dhe e shpalli fituese duke kërkuar edhe miratimin e kontratës, ndërsa ofertën e kompanisë “.....” e ka s`kualifikuar me pretendim teorik dhe të pa justifikueshëm se, kompania nuk ka prioritet cilësinë, pavarësisht faktit që zotëron një certifikatë ISO 9001. MEI nuk duhet të miratonte kompaninë fituese “...” me vlerë oferte 6,238,081 Euro, por duhet të miratonte fitues ofertuesin me çmimin më të lirë që ishte “.....” me ofertë 5,274,140 Euro. Nga këto veprime është rritur padrejtësisht, kosto e kësaj rruge për 963,941 Euro.**

Për sa më sipër është rekomanduar:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike **në vlerën 963,941 Euro.**

Menjëherë

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, janë lënë rekomandime në lidhje mbi Procedurat konkurruese për aplikim të lejeve minerare, si më poshtë vijon:

PROPOZIME PËR PËRMIRËSIME NË LEGJISLACION NË FUQI

Në vitin 2014, janë shpallur për konkurrim 104 Zona Minerare dhe janë zhvilluar 58 procedura konkurrimi. Nga të cilat: 8 procedura janë anuluar, në 46 procedura nuk janë paraqitur oferta dhe për 50 procedura është shpallur fituesi dhe nga këto janë audituar me zgjedhje 44 procedura, ose 88 % e tyre, dhe kanë rezultuar me shkelje dhe mangësi 37 procedura, ose 84 % e tyre.

Në vitin 2015, janë shpallur për konkurrim 75 Zona minerare dhe janë zhvilluar 49 procedura konkurrimi. Nga të cilat: 1 procedurë është anuluar, në 24 procedura nuk janë paraqitur oferta, 5 procedura kanë rezultuar pa fitues, për 43 procedura është shpallur fituesi dhe nga këto janë audituar 39 procedura, ose 91 % e tyre dhe rezultuan me mangësi 25 procedura, ose 64 % e tyre.

Në vitin 2016, janë shpallur për konkurrim 46 Zona minerare dhe janë zhvilluar 29 procedura konkurrimi. Nga të cilat: 2 procedura janë anuluar, në 7 procedura nuk janë paraqitur oferta, për 8 procedura nuk është shpallur asnjë fitues, për 20 procedura është shpallur fituesi dhe nga këto janë audituar 11 procedura, ose 55% e tyre dhe të 11 rezultuan me mangësi. U konstatua:

Gjetja1.

Në të gjitha rastet e procedurave të konkurrimit për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, është bërë në tejkallim të afatit të përcaktuar me VKM nr. 320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të

kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, pika 7.19, germa (c), ku cilësohet: “Afati maksimal i vlerësimit të ofertave është 30 ditë nga data e publikimit të ftesës për ofertë dhe mund të shtyhet për raste të veçanta, të argumentuara jo më shumë se 10 ditë”.

Afati i përcaktuar në VKM e mësipërme nuk është i zbatueshëm për dy arsye:

- Së pari, vetë afati për dorëzimin e ofertave nga data e publikimit të ftesës për ofertë në APP është 30 ditë;

- Së dyti, publikimi i ftesës për ofertë bëhet për disa zona minerare e për rrjedhojë për procedura të veçanta, të cilat detyrimisht kanë afate kohore të ndryshme për hapjen e tyre.

Për këtë rekomandoj:

Pika 7.19, germa (c) e VKM nr. 320, datë 21.04.2011 është: “*Afati maksimal i vlerësimit të ofertave është 30 ditë nga data e publikimit të ftesës për ofertë dhe mund të shtyhet për raste të veçanta, të argumentuara jo më shumë se 10 ditë*”.

pika 7.19, germa (c) të bëhet: “*Afati maksimal i vlerësimit të ofertave është 30 ditë nga data e hapjes së procedurës së konkurrimit, të përcaktuar në ftesën për ofertë të publikuar në buletin e APP-së, si dhe mund të shtyhet për raste të veçanta, të argumentuara jo më shumë se 10 ditë*”.

Gjetja2.

Vendosja e gjobave nga AKBN në disa raste është bërë duke mos respektuar afatet ligjore të ndarjes në tre mujorë. Referuar nenit 18/1,b,c dhe 25/1,b,c të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 me ndryshime, subjekti minerar ka detyrimin ligjor “*të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse (AKBN) çdo 3 muaj jo më vonë se data 15 e muajit që vijon pas tremujorit përkatës, një informacion mbi realizimin e prodhimit...*”. AKBN në kundërshtim me këtë kërkesë të ligjit, ka vendosur gjoba duke mos iu referuar tremujorit përkatës nga data e lëshimit të lejes nga QKL (sot QKB) por duke iu referuar tremujorëve të ndarë sipas vitit kalendarik në zbatim të Urdhrave të Ministrit nr. 201, datë 20.6.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jo metalore, qymyret dhe bitumet” dhe nr. 202, datë datë 20.6.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve ndërtimore”, të cilat bien në kundërshtim me nenin 18/1,b dhe 25/1,b të ligjit. Për pasojë, në llogaritjen e afateve për vendosjen e gjobave nga AKBN, janë mbajtur qëndrime të ndryshme për leje minerare të ndryshme. Gabimi në llogaritjen e afateve nga AKBN, ka sjellë si pasojë që masa administrative të shfuqizohet nga Komisioni i Vlerësimit të ankimeve.

Për këtë rekomandoj:

Nga MEI të analizohen përcaktimet ligjore mbi afatin për paraqitjen e informacionit 3 mujor për realizimin e prodhimit nga subjektet minerare sipas kërkesave të nenit 18/b,c dhe nenit 25/b,c të ligjit nr.10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” me ndryshime, dhe afatit të përcaktuar në Urdhërat e Ministrit nr.201, datë 20.6.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jo metalore, qymyret dhe bitumet” dhe nr. 202, datë 20.6.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve ndërtimore”, duke lënë në vlerësimin e tij nëse gjykohet e arsyeshme që të kërkohen përmirësime ligjore në nenin 18/b,c dhe nenit 25/b,c të këtij ligji apo të bëhet përshtatja e urdhrave të ministrit të dala në këtë rast me ligjin në fuqi “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim që të mos ketë mospërputhje mes ligjit dhe akteve normative të Ministrit (Urdhërat).

Menjëherë

MASA ORGANIZATIVE

Gjetja 1.

Nga Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative (Njësia), janë marrë në shqyrtim ankime të subjekteve, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrit nr. 10 datë 26.01.2015 “Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankimeve administrative të subjekteve minerare të licencuara”, pikën 11 ku cilësohet: “Njësia fillimisht, verifikon paraprakisht kushtet formale të ankesës”, pasi në 34 raste subjektet ankimuese nuk kanë plotësuar kërkesat mbi dokumentacionin që duhet të paraqesin, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrit nr. 10 datë 26.01.2015 “Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankimeve administrative të subjekteve minerare të licencuara”, pika 4 “Ankimi me shkrim dhe dokumentacioni që i bashkëngjitet”. Marrja në shqyrtim nga Njësia e këtyre rasteve, në kundërshtim edhe me pikën 4 dhe 11, të udhëzimit të sipërcituar, ka shkaktuar efekt financiar negativ (gjoba të pa arkëtuara) në vlerën 4,750,000 lekë.

Për këtë rekomandoj:

Të rishikohen vendimet e marra në kundërshtim me pikën 4 dhe pikën 11 të Udhëzimit nr. 10, datë 26.01.2015 “Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankimeve administrative të subjekteve minerare të licencuara”, për 34 praktikat (sipas aneksit bashkëlidhur), duke lënë në fuqi masat administrative të vendosura nga AKBN, për vlerën 4,750,000 lekë. Pas shqyrtimit nga Njësia e vendimeve të shfuqizimit të bëhet arkëtimi i kësaj vlere në buxhet.

Menjëherë

Gjetja 2.

Nga Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative (Njësia), janë marrë në shqyrtim ankime të subjekteve, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrit nr. 10 datë 26.01.2015 “Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankimeve administrative të subjekteve minerare të licencuara”, pikën 11 ku cilësohet: “Njësia fillimisht, verifikon paraprakisht kushtet formale të ankesës”, pasi në 34 raste subjektet ankimuese nuk kanë plotësuar kërkesat mbi dokumentacionin që duhet të paraqesin, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrit nr. 10 datë 26.01.2015 “Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankimeve administrative të subjekteve minerare të licencuara”, pika 4 “Ankimi me shkrim dhe dokumentacioni që i bashkëngjitet”. Marrja në shqyrtim nga Njësia e këtyre rasteve, në kundërshtim edhe me pikën 4 dhe 11, të udhëzimit të sipërcituar, ka shkaktuar efekt financiar negativ (gjoba të pa arkëtuara) në vlerën 2,950,000 lekë.

Për këtë rekomandoj:

Të rishikohen vendimet e marra në kundërshtim me pikën 4 dhe pikën 11 të Udhëzimit nr. 10, datë 26.01.2015 “Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankimeve administrative të subjekteve minerare të licencuara”, për 15 praktikat (sipas aneksit bashkëlidhur) duke lënë në fuqi masat administrative të vendosura nga AKBN, për vlerën 1,850,000 lekë për 9 raste në vitin 2016 dhe në vlerën 1,100,000 lekë për 6 raste në tremujorin e parë viti 2017. Pas shqyrtimit nga Njësia e vendimeve të shfuqizimit të bëhet arkëtimi i kësaj vlere në buxhet.

Menjëherë

Gjetja 3.

Rezultuar se, vendimi nr. 157, datë 11.12.2015, i Njesisë së Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative, është në kundërshtim me nenin 49 “Detyrimet e zotëruesit pas revokimit të lejes”, pika 2 ku cilësohet: “Zbatimi i sanksioneve administrative të pezullimit apo revokimit të lejes nuk e liron zotëruesin nga detyrimet e këtij ligji dhe nga përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar, sipas legjislacionit në fuqi”. Për më tepër, subjekti “....” shpik zotërues i lejes minerare nr. 413, datë 27.05.1998, vetëm 6 ditë para afatit të raportimit ka paraqitur kërkesën, e cila është në proces shqyrtimi, pra nuk kemi miratim të saj. Kërkesa për mbyllje të aktivitetit minerar duhet të bëhet sipas përcaktimeve në nenin 18.1.d ku cilësohet: “të japë informacione dhe shpjegime 1 vit më parë, nëse kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar”. Fillimi i procedurës për mbyllje të aktivitetit, nuk e përjashton detyrimin e subjektit për raportim dhe dhënie informacioni sipas nenit 18. Subjekti nuk e ka dorëzuar informacionin dhe gjoba në masën 250,000 lekë nuk duhej të shfuqizohej.

Për këtë rekomandoj:

Të merren masa për shfuqizimin e vendimit nr. 157, datë 11.12.2015 dhe kundrejt subjektit të merret masa administrative me gjobë në masën 250,000 lekë, për mosdorëzim në afatet e përcaktuara, të planit vjetor minerar, sipas përcaktimeve në nenin 18.1.ç, të ligjit nr. 10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në RSH”.

Menjëherë**Gjetja 4.**

Me vendimin nr. 62, datë 08.05.2015, Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative, ka lënë në fuqi gjobën në vlerën 250,000 lekë, për mosdorëzim të planit vjetor minerar nga subjekti “.....” zotërues i lejes minerare nr. 1510, në kundërshtim me nenin 18.1.ç të ligjit nr. 10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në RSH”, datë 29.10.2010. Përgjegjës për dorëzimin e planit vjetor të vitit 2014, ka qenë subjekti “.....” i cili ka qenë zotëruesi i lejes minerare nr. 1510, datë 15.07.2010, deri më datë 07.03.2014, koha kur leja minerare është transferuar nga subjekti “.....” tek “.....” me Akt miratimin nr. 1688, datë 07.03.2014. Njësia në kundërshtim me ligjin nr. 10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në RSH”, neni 41 dhe 42, ku citohet: “Transferuesi i lejes minerare është përgjegjës për të gjitha detyrimet ndaj shtetit deri në momentin e transferimit”, detyrimin për gjobën ja ka lënë subjektit “.....”. Sa më sipër, njësia ka vepruar në kundërshtim me ligjin, detyrimi i përket subjektit “....”.

Për këtë rekomandoj:

Të merren masa për shfuqizimin e vendimit nr. 62, datë 08.05.2015 dhe gjoba në vlerën 250,000 lekë për shkelje të ligjit nr. 10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në RSH” neni 18.1.ç, të vendoset kundrejt subjektit “...” i cili ka detyrimin ligjor për raportim, në zbatim të nenit 41 dhe 42 të ligjit.

Menjëherë**Gjetja 5.**

Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative, me vendimin nr. 94, datë 27.07.2015, ka shfuqizuar masën administrative në vlerën 2,000,000 lekë të vendosur ndaj subjektit “...”, zotërues i lejes minerare nr. 969, datë 05.09.2006, për shkelje të nenit 45 pika 1, germa a, të ligjit nr. 10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në RSH”. Sipas aktit të masës administrative ky subjekt ka kryer punime minerare jashtë sipërfaqes së miratuar të lejes minerare. Për të vërtetuar pretendimet e subjektit “...” shpk, grupi i punës së Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë sipas aktit të mbajtur më datë 14.05.2015, ka matur koordinatat e 7 pikave, të cilat nuk përkojnë me koordinatat e 4 pikave të sipërfaqes së miratuar të lejes minerare nr. 969, datë 05.09.2006, por të zonës minerare nr.376/4, që nuk është objekt i këtij shqyrtimi nga Njësia. Për të verifikuar pretendimin e subjektit për mos tejkallim të sipërfaqes së punimeve minerare sipas lejes minerare, grupi i punës duhet të sillte të detajuar pikërisht matjet e sipërfaqes së punuar. Nga grupi i punës është matur sipërfaqja e zonës minerare nr. 376/4, brenda së cilës është dhënë leja minerare nr. 969, datë 05.09.2006. Kjo nuk vërteton se ku është punuar faktikisht nga subjekti shpk, zotërues i lejes minerare nr. 969, datë 05.09.2006. Grupi i kontrollit as nga matjet (harta) dhe as në informacionin e dhënë me shkrim, nuk është shprehur se po punohet brenda koordinatave të 4 pikave sipas lejes minerare.

Sa më sipër, nga Njësia nuk duhej të shfuqizohej gjoba për tejkallim të kufijve të sipërfaqes, sipas lejes minerare, pasi veprimtaria minerare jashtë konturit të LM do të konsiderohet “kryerje e veprimtarisë minerare pa leje minerare” dhe për subjektin “...” , i cili ka kryer veprimtari minerare jashtë kontureve të lejes minerare të miratuar do të qëndrojë penaliteti sipas nenit 45.1 në vlerën 2,000,000 lekë, i shfuqizuar në kundërshtim me ligjin nga Njësia.

Për këtë rekomandoj:

Të merren masa për shfuqizimin e vendimit nr. 94, datë 27.07.2015 dhe të merret vendim për vendosjen e gjobës në vlerën 2,000,000 lekë, ndaj subjektit “...” shpk për punime jashtë kufijve të miratuar të lejes minerare, referuar nenit 45 “Kundërvajtjet administrative”, pika 1 germa a, të ligjit nr. 10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në RSH”.

Gjetja 6.

Nga auditimi ka rezultuar se në disa raste, nga specialistët e AKBN-së, janë vendosur gjopa për subjekte të cilat kanë rezultuar me leje minerare të mbyllura ose të revokuara kohë më parë, si dhe për raste, kur nga subjekti ishte kryer dorëzimi i informacioneve dhe planit minerar, pranë protokollit të AKBN-së. Kjo problematikë është rezultat i mosbashkëpunimit me strukturat përgjegjëse, në qarkullimin e informacionit dhe vendimmarrjeve mbi lejet minerare, si dhe i mungesës së “Regjistrimit minerar”, ku në nenin 2.33 të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në RSH” cilësohet: “Regjistri minerar është regjistri që përfshin të gjitha të dhënat për regjimin juridik të sipërfaqeve të zonave minerare dhe të sipërfaqeve fqinje, pronësisë, situatën topografike të zonave minerare e të punimeve mbështetëse të veprimtarisë minerare për rezervat dhe për prodhimin minerar, si dhe të dhënat për zotëruesin e lejeve minerare”. Përgjegjës për mungesën e “Regjistrimit minerar” sipas nenit 44.1 të ligjit, janë Strukturat përgjegjëse, të cilat janë administrueset e kadastrës minerare dhe regjistrimit minerar dhe që janë të përcaktuara si të tilla në VKM nr. 232, datë 23.03.2011, si dhe Urdhrin e Ministrisë nr. 384, datë 20.05.2011 “Për miratimin e procedurave të regjistrimit të dokumentacionit që regjistrohet në kadastrën minerare dhe në regjistrimin minerar, si dhe forma dhe procedurat e raportimit të këtij dokumentacioni nga ana e zotëruesve të lejeve minerare”, pika 18.

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë të marrë masa për rritjen e bashkëpunimit dhe hartimin e Regjistrimit Minerar, duke koordinuar punën edhe me strukturat e tjera përgjegjëse të përcaktuara në ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në RSH” .

Menjëherë

Gjetja 7.

Në zhvillimin e procedurave të konkurrimit për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare, nga Autoriteti Kontraktor nuk ka ekzistuar një referencë e qartë ligjore mbi mënyrën e zhvillimit të procedurave të konkurrimit, si dhe nuk janë miratuar Dokumente Standarde të Procedurës së Konkurrimit (DSPK). Dokumentet e Procedurave të Konkurrimit ju janë referuar VKM nr. 320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, po ashtu për pjesë të veçanta “Ligji për koncesionet” dhe ligji “Për prokurimin publik”. Mungesa referencave të qarta ligjore dhe DSPK, ka krijuar mundësinë e përdorimit të standardeve të ndryshme për të njëjtat procedura, si të kërkesave të përgjithshme ligjore, po ashtu edhe atyre të veçanta e specifike, të kriterëve për kapacitetet teknike, profesionale dhe financiare.

Për këtë rekomandoj:

Autoriteti Kontraktor, të marrë masa për hartimin e Dokumenteve Standarde të Procedurës së Konkurrimit (DSPK), në të cilat të përcaktohet qartë referenca ligjore, kriteret e përgjithshme për kualifikim, kriteret e veçanta dhe specifike, mbi të cilat në proporcion me sipërfaqen e Zonës Minerare të shpallur për konkurrim, volumit të parashikuar të prodhimit dhe vlerës së parashikuar të investimit, të përcaktohen nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve të procedurës së konkurrimit dhe të miratohen nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për çdo procedurë në veçanti, kriteret për kapacitetet profesionale (numri i stafit drejtues, fuqia punëtore, dëshmitë që duhet të paraqesin dhe kontratat e punës me qëllim që të vërtetohet lidhja me subjektin konkurrues), të përcaktohen kriteret për kapacitetet teknike (numri dhe lloji i makinerive), të përcaktohen kriteret për kapacitetet financiare (xhiroja vjetore, pasqyrat financiare, gjendja në llogarinë bankare, lloji i dokumentacionit) etj.

Menjëherë

Gjetja 8.

Në zhvillimin e procedurave të konkurrimit për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare, nga Autoriteti Kontraktor nuk ka ekzistuar një referencë e qartë ligjore, mbi afatet

e ankimit nga subjektet konkurruese, radhës dhe strukturave ku duhet të drejtohen subjektet ankuese.

Për këtë rekomandoj:

Në Dokumentet Standarde të Procedurave të Konkurrimit të përcaktohen strukturat, afatet si dhe radha e ankimit në përputhje me VKM nr. 320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, po ashtu edhe në legjislacionin “Për prokurimin publik”, për aq sa nuk bien ndesh me njëra-tjetrën.

Menjëherë

Gjetja 9.

Në formularin “Kriteret Specifike të Kualifikimit” të DSPK-ve, paragrafi i fundit, është vendosur shënimi “Ofertuesit janë të detyruar të përgatisin përmbajtjen në zarin e parë sipas radhës...Në të kundërt nëse qoftë edhe një nga dokumentet e mësipërme nuk janë të plotësuar ato do të refuzohen dhe ofertuesi s`kualifikohet”. Vendosja e një kriteri të tillë duhet të formalizohet dhe të jetë pjesë përbërëse e Aneksit VI-A “Metodologjia e vlerësimit për leje minerare shfrytëzimi”. Konkretisht në DSPK nuk përcaktohet qartë se vlerësimi i ofertave kalon në dy faza, veçse vendoset “shënimi” te formulari “Kriteret Specifike të Kualifikimit” si dhe metodologjia e vlerësimit për çdo kriter sipas Aneksit VI-A.

Për këtë rekomandoj:

Të bëhet rregullimi i DSPK-ve për sa i përket “kriterëve të vlerësimit të ofertës” nga KVO, ku të saktësohet që vlerësimi i ofertës behët në 2 faza, faza e parë nënkupton vlerësimin që bëhet për paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar dhe faza e dytë, nënkupton vlerësimin më pikë për çdo kriter të ofertës sipas Aneksit VI-A “Metodologjia e vlerësimit për leje minerare shfrytëzimi/leje kërkim zbulimi” bazuar në dokumentacionin e paraqitur në fazën e parë. Të përcaktohet në kolonën “vlerësimi në pikë” të këtij Aneksi, vlera minimale dhe maksimale për çdo kriter, me qëllim që totali i pikëve i dalë të përcaktojë ofertën fituese sipas të cilës oferta që ka grumbulluar pikë më shumë të konsiderohet si oferta më e suksesshme.

Menjëherë

Gjetja 10.

Shqyrtimi i ankesave, drejtuar nga subjektet konkurruese pranë Autoritetit Kontraktor, është kryer nga i njëjti komision, ai i vlerësimit të ofertave (KVO). Vendimi i s`kualifikimit nga gara, por edhe ai i kualifikimit pas shqyrtimit të ankesës është bërë nga e njëjta KVO, duke vepruar në mungesë të një urdhri nga titullari, ku ngarkon këtë KVO, për shqyrtimin e ankesës dhe në kundërshtim me afatet e përcaktuara në VKM nr. 320, datë 21.04.2011, si dhe në kushtet e konfliktit të interesit.

Për këtë rekomandoj:

Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masa për ndërprerjen e kësaj praktike. Në rastet e ankesave nga subjektet konkurruese pranë AK, me urdhër të Titullarit të AK, duhet të krijohet komision tjetër për shqyrtimin e tyre dhe ri klasifikimin e konkurrentëve.

Menjëherë

Gjetja 11.

Shqyrtimi i ankesave të paraqitura nga subjektet konkurruese, është kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, komision i cili është shprehur njëherë me vendim për vlerësimin e ofertave të subjekteve pjesëmarrëse në garë. Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor nuk është ngritur një komision i ri, për shqyrtimin e tyre. Shqyrtimi i ankesave nga i njëjti komision, është në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe KVO është në kushtet e legjitimitetit, pasi nuk ka asnjë urdhër nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, apo bazë ligjore që ja ngarkon të njëjtës KVO shqyrtimin e tyre.

Për këtë rekomandoj:

Autoriteti kontraktor të marrë masa të menjëhershme për të përcaktuar qartë në Dokumentet Standarde të Procedurës së Konkurrimit, referencën ligjore, mënyrën e shqyrtimit të

ankesave të subjekteve konkurruese, miratimin e KVO-së që do të shqyrtoje këto ankesa, shkallët që duhet të ndiqen, si dhe afatet për çdo shkallë ankimi.

Menjëherë

B. ISH MINISTRINA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

Nga KLSH për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar:

a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore dhe nënligjore** 1 rekomandim, nga të cilat është pranuar plotësisht 1 rekomandim, i cili është në proces zbatimi.

b. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 10 **masa organizative**, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 10 rekomandime, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 2 rekomandime, në proces zbatimi 4 rekomandime dhe të pa zbatuar 4 rekomandime.

c. Janë rekomanduar 9 **masa zhdëmtimi**, nga të cilat janë pranuar plotësisht 9 rekomandime, nga të pranuarat janë të pa zbatuar 9 rekomandime. Në vlerë leku dëm ekonomik i shkaktuar është 55,555,207 lekë gjithsej, nga i cili: I arkëtueshëm 40,098,007 lekë,

d. Janë rekomanduar dy masa për përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike, nga të cilat janë pranuar plotësisht 2 rekomandime, nga të pranuarat janë në proces zbatimi 2 rekomandime.

MASA ORGANIZATIVE.

Gjetja 1. Për vitin 2014 dhe 2016 MTI nuk ka nxjerrë “Manuallet teknike të çmimeve për punimet e ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre të rishikuara”, të cilët shërbejnë/përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim, në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se ...Manuali teknik i çmimeve për punimet e ndërtimit është buletini periodik vjetor ... i çmimeve të materialeve të ndërtimit ...të ofruara nga tregu përkatës, brenda vendit, në muajin maj...

Arsyeja është se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk i ka dërguar/ose i ka dërguar jo të plota MTI, të dhënat për çmimet mesatare të tregut të katër elementeve të strukturës së kostos, të nevojshme për përditësimin e çmimeve të manualit.

Gjatë shqyrtimit të materialeve të sjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në MTI për vitin 2016, u vërejt se DPT nuk i është referuar listës së materialeve bashkëlidhur shkresës zyrtare të dërguar nga MTI, e cila përmban rreth 800 materiale, ndërkohë që shumë prej zërave që përfshihen në listën shoqëruese, nuk kanë çmime reference të investiguara.

Të dhënat janë dërguar drejtpërdrejtë vetëm nga 7 Drejtori Rajonale Tatimore (jo nga DPT), kurse Drejtoria Rajonale Tiranë, ka dërguar si “çmime mesatare tregu” 5 akte konstatimi të mbajtur nga inspektorët e verifikimit në terren, për 5 subjekte tregtarë që ushtrojnë veprimtarinë nën juridiksionin e kësaj Drejtorie. Bashkëlidhur secilit akt-konstatimi janë dorëzuar lista çmimesh për produkte që këto subjekte tregtojnë, në të cilët, përgjithësisht evidentohen produkte me emërtim të njëjtë por me çmime të ndryshme, duke mos u përcaktuar asnjë specifikë dalluese/diferencuese midis tyre (materiali, dimensione etj.).

Nga shqyrtimi rastësor i çmimit të vendosur në “Manuallet Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe Analizave Teknike ...” të vitit 2015, për dy zëra punimesh të trajtuar më gjerësisht në projektraport, u konstatuan diferenca të ndjeshme të tyre për produkte/materiale të njëjtë në formë, dimension, cilësi etj, të cilat nuk argumentohen/justifikohen.

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e cila është përgjegjëse për përditësimin çdo vit, të analizave teknike të çmimeve, të bashkërendojë punën drejtpërdrejtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me qëllim që kjo e fundit të vërë në dispozicion çmimet e "investiguara", në bazë të kërkesës së bërë nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, brenda afateve të përcaktuara ligjore, duke përdorur gjithë masat shtrënguese që parashikon

ligji, me qëllim jo vetëm sigurimin cilësor të “çmimeve mesatarë ...” por edhe brenda afateve kohorë ligjorë për vitin 2017.

Nisur nga diferenca e ndjeshme e pa justifikuar/argumentuar e çmimit për zëra të ngjashëm të punimeve, MTI të shtrijë shqyrtimin/verifikimin me qëllim saktësimin e çmimit jo vetëm për zërat e punimeve të evidentuar, por për gjithë listën e materialeve objekt i rishikimit të çmimeve.

Menjëherë dhe në Vazhdimësi

Gjetja 2. Prej vitit 2014 e në vazhdim në “Relacionin” e pasqyrave financiare, në përbërje të llogarisë Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (llog 423,429) gjendet shuma prej 813,998 lekë e mbartur nga viti 2007 me sqarimin se ... është duke u ndjekur nga sektori juridik. Po kështu, u konstatua se në llogarinë 468 gjenden “debitorë të ndryshëm” që i përkasin një aktivi të vjedhur dhe detyrimeve të lëna nga raportet e KLSH të viteve të mëparshëm. Mos veprimi mëtejshëm për arkëtimin e tyre, po çon gradualisht në “parashkrimin”/faljen e tyre

Për këtë rekomandoj:

Drejtoria Juridike dhe Drejtoria Ekonomike të përcaktojë përgjegjësitë për këtë gjendje dhe të bashkërendojnë punën për arkëtimin e të drejtave të mbartura gjatë viteve të mëparshme me qëllim arkëtimin e detyrimeve para afatit të parashkrimit të tyre.

Menjëherë

Gjetja 3. Gjatë auditimit të llogarisë “furnizime dhe materiale të tjera dhe të përgjithshme” u konstatuan raste për mallra si “Blerje licenca etj.”, për të cilat mungon procesverbali i marrjes në dorëzim, në kundërshtim me pikën 42 dhe 47 të udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Për këtë rekomandoj:

Nga Drejtoria e Financës, për të gjitha praktikatat e evidentuara gjatë auditimit, të ngrihen grupet për marrjen në dorëzim të mallrave konform dokumentacionit shoqërues/justifikues të blerjes, me qëllim pasqyrimin/regjistrimin në ditarin e magazinës dhe ditarin e përgjithshëm të shpenzimeve.

Menjëherë

Gjetja 4. MTI mbështetur në VKM nr. 426 datë 9.7.1998 “Për përballimin nga shteti të shpenzimeve të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë vendit” i ndryshuar, kryen pagesa të konsiderueshme për rimbursimin e shpenzimeve të varrimit për shtetasit shqiptar që humbin jetën jashtë shtetit. Gjatë auditimit të dokumentacionit të tyre, u konstatua se mungon një bazë të dhënash në lidhje me përfituesit e rimbursimit. MTI nuk ka një procedurë sipas të cilës të bëhet verifikimi paraprak nëse rimbursimi drejt personave kërkues është kryer më parë apo jo. Ndërkohë personat përfitues të rimbursimit të këtyre pagesave të cilët banojnë në bashki të ndryshme brenda vendit, për marrjen e tij në MTI, ngarkohen me kohë dhe shpenzime shtesë.

Për këtë rekomandoj:

MTI, për të lehtësuar personat përfitues për rimbursimin e shpenzimeve të varrimit për shtetasit shqiptar që humbin jetën jashtë vendit, është e nevojshme të bëjë një zgjidhje fundore të tyre. Për këtë qëllim t’i kërkojë/propozojë Këshillit të Ministrave kalimin e kompetencave në lidhje me këtë shpenzim njësisive të qeverisjes vendore si një mënyrë jo vetëm për reduktimin e riskut të rimbursimit dy herë të të njëjtit përfitues, por njëkohësisht dhe lehtësimin e përfituesve për këtë shërbim.

Menjëherë

MASA SHPËRBLIM DËMI

Dëm ekonomik i shkaktuar është 55,555,207 lekë gjithsej, nga i cili: **B.I. I arkëtueshëm 40,098,007 lekë**, për të cilin kërkohet të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore

arkëtimi i saj, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

I. Për 30 punonjës dhe ish punonjës të MTI sipas listë pagesave të deklaruara (bashkëlidhur), shumën **27,338,969 lekë gjithsej**, nga të cilat *21,553,147 lekë për vitin 2014 dhe 5,785,822 lekë për 2015*, të përfituar padrejtësisht për shkak të trajtimit të tyre si punonjës në “listë pritje”.

Termi “listë pritje” ka lindur/është përdorur në nenin 50/2 të Ligjit nr. 8549 datë 11.11.1999 “Për nëpunësin civil”, të është përcaktuar se ... *Në rastet e ristrukturimit të institucioneve të administratës publike, nëpunësve civilë, vendet e të cilëve janë deklaruar të tepërt, do t'u ofrohet një vend i të njëjtit nivel në një ministri apo institucion tjetër të administratës publike qendrore apo vendore ose në pamundësi, një vend i një niveli më të ulët. Nëpunësi civil vazhdon të gëzojë të drejtat e vendit të tij të mëparshëm deri sa atij t'i ofrohet një vend tjetër, por jo për më tepër se një vit. Në rastet kur nëpunësi civil refuzon të pranojë vendin e ofruar, ai humbet të drejtat që i takojnë si nëpunës civil.*

Ky ligj është shfuqizuar me Ligjin nr. 152/2013 datë 30.5.2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, i cili nuk parashikon më “Listë pritje” për punonjësit gjatë ristrukturimit të institucioneve të administratës publike.

Në nenin 50 të Ligjit nr. 152/2013 datë 30.5.2013 për sistemimin e punonjësve në vende vakante është përcaktuar se ... *Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori.*

Transferimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet me precedencë, sipas kësaj renditjeje: a) në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; b) në institucionin, me të cilin institucioni është shkruar apo bashkuar, në një nga institucionet, në të cilat institucioni është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; c) në institucionet e varësisë së institucionit të ristrukturuar; ç) në një institucion tjetër të shërbimit civil...

Nga krahasimi midis dy ligjeve konstatohet se termi “Listë pritje”, nuk ekziston në Ligjin 152/2013 datë 30.5.2013.

Nën këtë arsyetim pagesat e kryera nga MTI për punonjësit në “Listë pritje” është i kundërligjshëm dhe përbën dëm ekonomik për Institucionin.

2.Për tre punonjës dhe ish punonjës të MTI shumën **8,535,032 lekë gjithsej**, e cila përfaqëson pagesën e kryer ish punonjësve të cilët kanë fituar me vendim të formës së prerë të gjykatave “Pagesë deri në rikthim në punë”, në kushtet kur këta punonjës kanë qenë në marrëdhënie pune në institucione të tjera shtetërore ose private si më poshtë:

2.1. **M. H.** për periudhën Qershor 2012-Gusht 2016 *ky kreditor* ka qenë i punësuar në Këshillin e Qarkut Tiranë. Për pasojë rezulton që për periudhën Qershor 2012 deri në Korrik 2015 të ketë përfituar pagesë të dyfishtë për 38 muaj, me pagë bruto 95,417 lekë/muaj, në total 4,886,267 lekë, e cila nën këtë arsyetim përbën dëm ekonomik.

1.1. **L. A.** ka qenë i punësuar për periudhën Dhjetor 2011-Shkurt 2014 në operator privat dhe për periudhën Shkurt 2014 e në vazhdim, në Këshillin e Ministrave. Për periudhën Dhjetor 2011 deri në Korrik 2014, është paguar në privat dhe Këshillin e Ministrave, ndërkohë që është paguar dhe nga MTI në zbatim të vendimit gjyqësor i cili përcakton pagesën ... *deri në rikthimin në punë...*

Pagesa e dyfishtë (me mbi vendosje për të njëjtën periudhë) është kryer për 32 muaj me pagë referuese 95,400 lekë/muaj në shumën totale 3,052,800 lekë, e cila përbën dëm ekonomik.

1.1 **Ll. P.** ka qenë i punësuar në MTI për periudhën nga Dhjetor 2011 deri në Prill 2013. Pagesa e përfituar në 2016 në zbatim të vendimit gjyqësor ... *deri në rikthimin në punë.*

Për periudhën Shtator 2012 deri në Prill 2013, për 8 paga gjithsej në shumën 624,000 lekë përfaqëson pagesë të dyfishtë (me mbi vendosje për të njëjtën periudhë) dhe përbën dëm ekonomik.

2. **Për tre raste të kryerjes së pagesës për tarifën përmbartimore në shumën 1,589.800 lekë gjithsej**, të cilat nuk kanë qenë të shoqëruara me faturë tatimore në kundërshtim me nenin 54 të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar” në të cilin është përcaktuar se ... *Shpenzimet e njëjësive të qeverisjes së përgjithshme verifikohen në bazë të dokumentacionit të plotë, që vërteton kryerjen e shpenzimit përkatës, sipas ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin...*

Pagesat janë kryer për shoqëritë përmbartimore si më poshtë:

3.1. *Shoqërisë Përmbartimore Stratti Baliff* në cilësinë e përfaqësuesit të Zyrës Përmbartimore të subjektit ... shpk vlerën 461.170 lekë paguar me urdhër shpenzimit nr. 254 datë 12.6.2014.

3.2. *Shoqërisë Përmbartimore Shkrela* vlerën 133,688 lekë paguar në likuidimin e bërë për vendimin gjyqësor në favor të E.Sh.

3.3. *Shoqërisë Përmbartimore Matani Co* vlerën 994,942 lekë paguar në likuidimin e bërë për vendimin gjyqësor në favor të H.L..

Deri në momentin e hartimit të këtij materiali, nga MTI nuk janë paraqitur fatura tatimore që të justifikojnë pagesën e kryer. Grupi i auditimit, mbështetur në sa më sipër, gjithë pagesën e kryer e ka konsideruar e paligjshme.

Menjëherë

3. Z.S. D. si përmbartues për kërkuesin/kreditorin Ilirian Bitincka, vlerën 1,391,000 lekë, e cila përfaqëson pagesë të kryer nga MTI, për të cilën gjykata nuk është shprehur në vendimin gjyqësor.

4. Z. S. D. me detyrë ish punonjës i MTI vlerën 18,000 lekë, e cila përfaqëson pagesë/llogaritje të gabuar, të kryer nga MTI, ndaj vlerës për të cilën është shprehur me vendim të formës së prerë gjykata (trajtuar në faqen 79-80 të Raportit të Auditimit).

Menjëherë

5. Operatorit ekonomik “...” SH. A. vlerën 120,450 lekë përfituar padrejtësisht, në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu VIII, pika 2/c.

Menjëherë

6. Operatorit ekonomik “...” SH.A. vlerën 732,086 lekë përfituar padrejtësisht, në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu VIII, pika 2/c dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5.

Menjëherë

7. Operatorit ekonomik “...” SH.A. vlerën 269,635 lekë sa përfituar padrejtësisht, në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu VIII, pika 2/c.

Menjëherë

8. Operatorit ekonomik “...” SH.A. vlerën 75,000 lekë përfituar padrejtësisht, në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu VIII, pika 2/c.

Menjëherë

Nga llogaritjet për karburantet e furnizuar dhe likuiduar në zbatim të kontratave përkatëse lidhur midis OE dhe AK, rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS, mbështetur në deklaratën doganore SAD në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu VIII, pika 2/c, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 6, “Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë përqindjen e rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters,

lëvruar sipas kushtit CIF Shqipëri, cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”, si rrjedhojë këto subjekte kanë përfituar padrejtësisht vlerën 1,197,171 lekë .

II. I pa arkëtueshëm aktualisht, por që do të realizohet me fillimin e punimeve nga Koncesionari.

1. Vlerën 15,457,200 lekë/vit gjithsej, BOE të përbërë nga OE “..”, Shoqëria “..”, Shoqëria “..” dhe Shoqëria “..” sh.p.k, fitues i koncesionit “Për dhënien me koncesion/PPP të ndërtimit, shfrytëzimit dhe transferimit (BOT) të një Porti Jahtesh në Portin e Shëngjinit, në formën e “Propozimit të pa kërkuar”.

Sipas pikës 2.4. “Sipërfaqe e Portit” të Kontratës lidhur datë 10.6.2016 lidhur midis MTI dhe BOE të përbërë nga OE “”, Shoqëria “..”, Shoqëria “” dhe Shoqëria “” sh.p.k, sipas së cilës ... *AK i njeh të drejtën Koncesionarit të përdorë ... sipërfaqe ujore përfshirë dhe kalatën perëndimore të Portit Shëngjin prej 31,578 m2 dhe një sipërfaqe tokësore prej 12,381 m2.*

Për përdorimin e aseteve, pronësisë pasuri shtetërore, Autoriteti kontraktor (MTI) nuk ka parashikuar Royalty Fee (qira etj.) që duhet të paguante Koncesionari, në shumën **15,457,200 lekë/vit gjithsej**, nga e cila për përdorimin/shfrytëzimin:

- *Sipërfaqe tokësore prej 12,381 m2 x 100 lekë/m2/muaj x 12 muaj = 14,857,200 lekë/vit, në zbatim të pikës 2 të Kreu-t të III të VKM Nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies më qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, në të cilën është përcaktuar se ... Kur jepet me qira truall i lirë, pra kur jepet me qira ose enfiteozë vetëm truall, tarifa dysHEME e qirasë mujore është 100 lekë/m2.*

- *Kalata perëndimore (dallgë thyesi) me sipërfaqe minimale jo më pak se 5,00 m2 me vlerë 600,000 lekë/vit. (Autoriteti Portual Lezhë, sipas inventarit kontabël të vitit 2013 ka investuar rreth 85,000 mijë lekë për kalatën perëndimore (dallgë thyesi). Në dokumentacion, nuk është shprehur sipërfaqe e dallgë thyesit, por nisur nga skica shoqëruese, sipërfaqja minimale e llogaritur rezulton jo më pak se 500 m2. Llogaritja e vlerës është bërë me të njëjtin arsyetim si për sipërfaqen tokësore).*

-*Sipërfaqe detare 31,578 m2 (dispozita të ndryshme ligjore shprehen se sipërfaqe ujore mund të jepet me qira për shfrytëzim ..., por nga audituesit, nuk u gjet ndonjë vlerë për këtë qëllim.AK/Komisioni “Për dhënien me koncesion/ppp...” ka vepruar në kundërshtim me:*

- *nenin 37 “Marrëdhëniet e pronësisë” të Ligjit nr. 125/2013 datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se ...*

Në rast se një kontratë koncesioni/partneriteti publik privat përfshin përdorimin e pasurisë në pronësi të një personi, që nuk është i përfshirë në procedurën për dhënie të kontratës, marrëdhëniet e pronësisë që shoqërojnë një pasuri të tillë duhet të zgjidhen sipas legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të mos pengohet realizimi i projektit gjatë periudhës së kontraktuar.

- *Nëse Republika e Shqipërisë është pronare e pasurisë së paluajtshme, të përfshirë në realizimin e një kontrate koncesioni/partneriteti publik privat, ose nëse koncesioni/partneriteti publik privat përfshin përdorimin e të mirave publike, atëherë autoriteti kontraktues zgjidh të gjitha marrëdhëniet e pronësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në një mënyrë që të mos pengohet realizimi i projektit gjatë periudhës së kontraktuar.*

- *nenin 27 “Përmbajtja e kontratës” të Ligjit nr. 125/2013 datë 25.4.2013 i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se ... Kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat rregullon, në përputhje me dokumentacionin e tenderit, me vendimin e dhënies së koncesionit dhe me ofertën e zgjedhur, të gjitha çështjet që janë të lidhura me pronësinë e pasurive të paluajtshme dhe pasurive të tjera, që janë objekt i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat dhe pronësinë e pasurive të paluajtshme ose jo, që lindin në bazë të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat për kohëzgjatjen e saj apo pas përfundimit të saj.*

Koncesionari e ka bërë sigurimin e kontratës vetëm për një vit, në vlerën 73,033,800 lekë në kundërshtim me nenin 6 “Sigurimi i kontratës” të Kontratës datë 10.6.2016 lidhur midis MTI dhe BOE, në të cilën është përcaktuar se ... *Koncesionari, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të Kontratës, gjatë gjithë periudhës koncesionare i paraqet Autoritetit Kontraktues një sigurim kontrate të parevokueshëm dhe të pagueshëm me kërkesën e parë... Sigurimi i kontratës do të jetë në masën 10 për qind të vlerës së investimit...*

Sigurimi i kontratës nga BOE duhet të ishte bërë për 35 vjet.

Për këtë rekomandoj:

MTI, në cilësinë e AK të saktësojë sipërfaqen e kalatës përëndimore, së bashku me sipërfaqen e tokës dhe basenit ujqor, të konvertuar në vlerë me qëllim rishikimin e kushteve të kontratës me Koncesionarin dhe përfshirjen e saj në kontratë si detyrim ligjor për pagesë të Koncesionarit ndaj MTI.

Gjithashtu MTI, t’i kërkojë Koncesionarit të bëjë sigurimin e kontratës për 35 vjet, në zbatim të kriterëve ligjorë të përcaktuara në DST etj, në të kundërt, të anulojë dhënien e koncesionit, duke sekuestruar garancinë e kontratës (*trajtuar në faqen 124-138 të Raportit të Auditimit*).

Menjëherë

C.TË TJERA

1. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2018, veçanarisht, arkëtimin e plotë të dëmit dëm ekonomik në vlerën 97,580,712 lekë, nga operatori ekonomik të përfituar padrejhtësisht gjatë zbatimit të kontratave për rehabilitimin e “Ndërmarrjes së Prodhimit të Çeliqueve” dhe “Uzinës 12 & Ni-Co”.

2. Për rekomandimet e pazbatuara që lidhen me shpërblimin e dëmeve, kërkojmë edhe njëherë **që, brenda muajit shtator 2018**, të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të bërë të mundur kthimin e këtyre fondeve buxhetore në arkën e shtetit.

Nëse, në përfundim të këtij afati, këto rekomandime **do te rezultojnë përsëri të pazbatuar**, KLSH në zbatim të nenit 15 germa “gj” të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, do të bëjë për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, **kallëzim penal në Organet e Prokurorisë**, si dhe do të njoftoj Komisionin Parlamentar për Ekonomin dhe Financat.

8. INSTITUCIONIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Nga auditimi i ushtruar mbi praktikën dokumentare të paraqitura nga stafi drejtues i Institucionit të Presidentit të Republikës, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ky Institucion, ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e dijeni dhe ka paraqitur informacion të detajuar lidhur me zbatimin e rekomandimeve në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 4 masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht dhe konsiderohen të zbatuar plotësisht

REZULTATET E AUDITIMIT

I. Hartimi i programit (Planit të veprimit), si dhe respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh nga data e marrjes së kërkesës për informimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (germa “j” e nenit 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014.

- Nga auditimi rezultoi se, Institucioni i Presidentit të Republikës me shkresën nr. 1080/17 datë 04.08.2017 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ka njoftuar KLSH për punën e bërë sipas afatit ligjor prej 20 ditëve nga marrja e njoftimit.

Rekomandimi është i pa zbatuar.

Në përfundim **rikërkojmë** Sekretarit të Përgjithshëm të Institucionit të Presidentit të Republikës, mbi auditimin me objekt “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*, për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2018.

9. MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË (ish-Ministrisë Së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë Dhe Sipërmarrjes”.

Nga auditimi në “Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, sot pjesë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara me shkresën e KLSH-së shkresën nr. 1191/12, datë 14.06.2017, dhe ri kërkuar me shkresën 1139/10 datë 03.11.2017, dhe praktikat dokumentare të paraqitura nga stafi drejtues i Institucionit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ky Institucion, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 15654/1, datë 13.12.2017, ka dërguar zyrtarisht raportin mbi ecurinë dhe progresin e bërë në fushën e zbatimit të rekomandimeve, planin e veprimit, si dhe materialet shkresore. Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014. Drejtoritë përkatëse pranë Institucionit, në adresë të të cilave janë lënë rekomandimet përkatëse, kane hartuar dhe miratuar Planin e Veprimit për programimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të lëna.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 masa për përmirësime ligjore, 33 masa organizative, dhe masa disiplinore për personat përgjegjës në lidhje me shkeljet e konstatuara të cilat i janë lënë në kompetencë ish-titullarit të institucionit të MZHETTS (sot titullar i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë) për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore sipas përgjegjësisë individuale të personave konkret, nga vërejtje deri në largim nga puna, të cilat, janë pranuar plotësisht dhe konsiderohen në proces zbatimi masat organizative, ndërkohë që me rekomandimin për marrjen e masave disiplinore nga ana e ish Titullarit të Institucionit dhe nga Drejtorët e Drejtorive (në cilësinë e eprorit të drejtëpërdrejtë) nuk është vlerësuar dhe propozuar ndërmarrja e procedurave për marrje mase disiplinore bazuar në rekomandimet e lëna nga KLSH.

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014.

- Nga auditimi rezultoi se, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka dërguar informacion për punën e bërë brenda afatit 6 muajor lidhur me zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 30 pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në përfundim **rikërkojmë** nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zbatimin e rekomandimeve të dërguara me shkresën e KLSH-së shkresën nr. 1191/12, datë 14.06.2017, dhe ri kërkuar me shkresën 1139/10 datë 03.11.2017, mbi auditimin me objekt “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara si më poshtë:

A. MASA PËR PËRMIRËSIME LIGJORE

1. Nga auditimi në Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve(ATRAKO), *për zbatimin e ligjshmërisë në evidentimin e koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat*, konstatohet se, deri më tani nga Këshilli i Ministrave nuk është hartuar e miratuar një dokument strategjik politikash për përcaktimin e sektorëve parësor për investime, të bazuara te partneriteti publik privat, të formave të preferuara të partneritetit publik privat dhe çështje të tjera që lidhen me kuadrin e përgjithshëm të politikave për koncesionet, kërkesë e nenit 8, pika 5 e ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet/PPP”, i ndryshuar.

Gjithashtu, konstatohet se edhe ministria përgjegjëse për ekonominë (MZHETTS), si institucioni përgjegjës, sipas nenit 9/1 të Ligjit të koncesioneve/ppp, nuk ka një studim të mirëfilltë të tregut dhe propozime prej saj, edhe pse duhet të orientojë dhe harmonizojë veprimtaritë për zhvillimin e koncesioneve/ppp.

Nga auditimi konstatohet se, nga strukturat e shtetit (Autoriteti Kontraktor) nuk ka një bashkëpunim të mirë në drejtim të identifikimit të projekteve, publikimit dhe monitorimit të tyre dhe këtu kemi parasysh jo vetëm veprimtarinë para Marsit 2016 (kohë kur ka dalë VKM nr. 211, datë 16.03.2016) por për të gjithë periudhën e mëparshme. Kjo punë do të kishte bërë të mundur realizimin jo vetëm të një regjistri të detajuar dhe të një monitorimi korrekt, por Qeveria shqiptare me eksperiencën e deritanishme në këtë fushë (tepër të debatuar) duhet të kishte tashmë një strategji të detajuar politikash në fushën e koncesioneve/ppp. ATRAKO në këtë veprimtari është vetëm një hallkë në këtë zinxhir institucionesh që mbulojnë këtë proces, e për pasojë dhe veprimtaria e saj është fragmentare duke pasur parasysh dhe varësinë institucionale të saj nga MZHETTS. (*Trajtuar më hollësisht në pikën V të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Në kuadër të hartimit të strategjisë së politikave dhe përcaktimin e sektorëve parësorë të zhvillimit të koncesioneve/ppp dhe në kuadër të miratimit (në proces) të Projekt Vendimit të KM “Për funksionimin e ATRAKO” nga ana e MZHETTS, ky institucion duhet të realizojë, të rivlerësojë, e të kërkojë rregullimin e varësisë institucionale dhe kompetencat funksionale të këtij institucioni, me qëllim realizimin sa më të mirë të misionit për të cilën është krijuar duke parashikuar që ATRAKO të funksionojë në rolin e një agjencie monitorimi duke pasur varësi nga Kryeministri.

2. Nga auditimi dokumentacionit të shoqërive për marrje me qira të pasurisë publike, u konstatua se, favorizimi i tyre nëpërmjet kontratave simbolike favorizuese “1 Euro”, është i paargumentuar dhe i pajustificuar, me tregues, teknikë, ekonomiko-financiarë, dhe tregues të tjerë që lidhen me burimet e punësimit, e konkretisht:

-Nuk ka të dhëna për prodhimin vjetor, të ardhurat, shpenzimet dhe fitimin vjetor me qëllim garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit të çdo shoqërie të interesuar për marrje me qira të pasurisë publike, madje duhet theksuar se edhe në një rast është lidhur kontratë favorizuese me “1 Euro” në një kohë kur kjo shoqëri deklaroi se ka një aktivitet të konsoliduar dhe fitim të akumuluar në fund të vitit 2015 në shumën prej 319,2 milionë lekë, çka tregon se nuk ka një përcaktim të saktë të shoqërive që duhen favorizuar me kontrata simbolike “1 Euro”;

-Nuk ka të dhëna apo tregues për burimin e financimit të investimeve, makineri, pajisjeve dhe ambienteve të tjera të shërbimit për trajtim të punëtorëve në se do sigurohen nga fitimi i aktivitetit ekzistues, apo me kredi bankare për të qenë të besueshëm në realizimin e shpenzimeve dhe çeljen e vendeve të reja të punës si kusht për përfitim të kontratës favorizuese “1 Euro”, duke lenë shteg për përdorim të mjeteve financiare jashtë kanaleve të bankës.

-Nuk ka të dhëna për aktivitetin aktual të subjekteve që kërkojnë të zgjerojnë prodhimin nëpërmjet objekteve shtesë si, treguesit ekonomikë, prodhimin e realizuar, koston për njësi shpenzimet e prodhimit dhe të ardhurat nga shitja, për të garantuar vazhdimësinë e treguesve pozitivë ekonomikë edhe në kontratën e re me kushte favorizuese “1 Euro”;

-Plan bizneset e shoqërive nuk janë të shoqëruar me treguesit e punësimit dhe të dhëna demografike për popullsinë e zonës dhe shkallën e papunësisë si një burim potencial për të garantuar numrin e fuqisë punëtore në objektin që kërkohet të merret me qira për zhvillim apo zgjerim aktiviteti.

- Nga auditimi konstatohet se në 7 raste është shpallur fitues subjekti i vetëm konkurrues, të cilët kanë deklaruar se do kryejnë investime tepër minimale që variojnë nga 2.8 deri 31 % të vlerës së përcaktuar në VKM nr. 54, datë 05.02.2014, duke mos justifikuar dhe argumentuar në këtë mënyrë edhe çeljen e vendeve të reja të punës.

Mangësitë e mësipërme nuk justifikojnë propozimet dhe miratimet e kontratave favorizuese simbolike “1 Euro”, pasi nuk janë argumentuar me vlerën e investimeve, treguesit ekonomiko-financiarë, burimet e financimit të investimeve dhe çeljen e vendeve të reja të punës, duke sjellë si pasojë përfitim të padrejtë nga 10 shoqëri dhe të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në shumën prej 2,466,681,000 lekë. (*Trajtuar më hollësisht në pikën V të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

a. Me qëllim që numri i të punësuarve të jetë në funksion të drejtë me kryerjen e investimeve për ti shërbyer përmirësimit të procedurave të dhënies me qira të pronës publike, por edhe garantimit të punësimit nëpërmjet investimeve të kryera nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes të marren masa të menjëhershme për iniciimin e ndryshimit në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiotezë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, kreu V, “Kontrata me tarifën simbolike 1 Euro/kontrata”, ku të përcaktohet që:“... kriterë vlerësuese bazë të jenë të dy kategoritë, respektivisht: Investimet dhe numri i të punësuarve, si kriterë në harmoni me njëri tjetrin”.

b. Krahas masave për ndryshimin e VKM nr. 54, datë 05.02.2014, MZHETTS në zbatim të pikës 3 të këtij vendimi, të hartojë dhe miratojë një udhëzim të veçantë për dhënien me qira të pasurisë publike, ku të përcaktohen edhe disa kriterë të tjera e konkretisht:

Të bëhet vlerësimi i trullit dhe e objektit e ku niveli i investimeve duhet detyrimisht të jetë mbi 200 për qind të vlerës së pasurisë së shpallur për konkurrim”;

Krahas të dhënave të mësipërme shoqëritë duhet të deklarojnë burimet e financimit të investimeve, me qëllim mospërdorimin e mjeteve monetare jashtë kanaleve të bankave;

Programet ekonomike, krahas treguesve ekonomike të shoqërohen edhe me tregues financiarë, si prodhimi i realizuar, kosto për njësi, shpenzimet e prodhimit, të ardhurat nga shitja, të dhëna demografike për popullsinë e zonës dhe shkallën e papunësisë si një burim potencial për sigurimin e fuqisë punëtore në objektin që kërkohet të merret me qira për zhvillim apo zgjerim aktiviteti, për të garantuar vazhdimësinë e treguesve pozitivë ekonomikë edhe në kontratën e re me kushte favorizuese “1 Euro”.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1.Nga auditimi i Programimit të **PBA 2015-2017 dhe PBA 2016-2018**, rezultoi se: është përgatitur nga grupet e menaxhimit të programeve në të dy fazat e programimit në kohë, por programimi me produkte ka mangësi në të dy periudhat e PBA: në llogaritjen e koston për njësi, në përpilimin e fishave të projekteve dhe në gabime të konstatuara në tabelat e shpenzimeve me artikuj në disa institucione. Kështu, në shumë produkte, ka ndryshime të theksuara në vlerë nga faza e dytë në fazën e parë të programimit, megjithëse sasia e produkteve nuk ndryshon. Pra programuar me kosto të dyfishuar, apo të përgjysmuar duke e krahasuar me fazën e parë të programimit, gjë e cila tregon për plotësimin dhe llogaritjen e PBA-së në mënyrë formale, e të pa korrigjuar as nga Drejtoria e Financës dhe as nga Ministria e Financës/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Kështu në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”/Aparati i MZHETTS, programimi me produkte është bërë për vitin 2016 në të dy fazat e PBA 2016-2018, me ndryshime të pa justifikuara në vlerë, si rrjedhim dhe në ndryshime të koston për njësi, janë edhe 2 programet e tjera të MZHETTS, si

programi “Zhvillimit ekonomik” dhe në programin “Mbështetje për Mbikqyrjen e Tregut dhe Infrastrukturën”, ndërsa për programin e “Zhvillimit të Turizmit”, nuk bëjmë dot krahasime me produkte me fazën e parë, sepse nuk është programuar në këtë fazë me produkte. Në shpjegimet e Drejtorisë së Financës është sqaruar se: “..bazuar në kërkesat buxhetore të institucioneve, në prioritetet e reja për zhvillimin e Sektorit të Turizmit, si një nga prioritetet e Qeverisë, mbështetur në Tavanet e reja buxhetore, për të përmbushur këto prioritetet dërguar nga Ministria e Financave, nga Ekipi për Menaxhimin e këtij Programi, në koordinim me Drejtorinë e Financës, **u rikonceptua dhe u përgatit PBA 2016-2018, Faza II-të Politikat, Qëllimet, Objektivat si dhe Produktet dhe Aktivitetet e lidhura me to për këtë program**” (Trajtuar më hollësisht në pikën I të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandoj:

Struktura drejtuese të këtij institucioni, Grupet e menaxhimit të programeve dhe Drejtoria e Financës, në zbatim të Ligjit organik të buxhetit, Ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm, të hartojnë, kontrollojnë Programimin Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe projekt buxhetor vjetor, jo vetëm në kohë, por të plotësuar me të gjithë elementet ligjorë, ekonomike dhe financiare, duke relatuar në çdo fazë të programimit në Ministrinë e Financës, ndryshimet e justifikuar, (shitesat apo pakësimet), në përshtatje me ndryshimet e strategjive sektoriale, duke zbatuar penalitete për struktura që nuk i zbatojnë dhe shkelin legjislacionin për këtë qëllim.

Në vijimësi

2.Nga auditimi konstatohet se punonjës të MZHETTS kanë qenë pjesë e veprimtarisë së Këshillave Mbikqyrës në 36 shoqëri tregtare të formës sh.a, miratuar rast pas rasti nga titullari i MZHETTS, veprimtari e cila është shpërblyer sipas dispozitave ligjore. Po kështu, konstatohet se po me miratim të titullarit janë caktuar punonjës të aparatit të ministrisë si pjesë e bordeve të institucioneve të varësisë, ku dhe kanë marrë shpërblyerimin për pjesëmarrje. Të ardhurat e përfituara nga këto veprimtari detyesore nuk bashkohen me pagat e vendit të punës dhe më pas ti nënshtroheshin tatimit dhe ndalesës për sigurimet shoqërore, por janë paguar në institucionin apo shoqërinë përkatëse. Kjo ka bërë që mbi këto të ardhura të aplikohet tatimi në burim prej 15% dhe jo tatimi i përshkallëzuar sipas nivelit të pagës. (Trajtuar më hollësisht në pikën III të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandoj:

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ti kërkojë njësitë të varësisë dhe shoqërive publike për nëpunësit e aparatit të ministrisë të caktuar në këshilla mbikëqyrëse apo borde pagesa të kryhet në llogarinë e MZHETTS dhe tatimi të jetë sipas nivelit të përcaktuar për këtë rast.

Menjëherë

Nga auditimi në Agjencinë Kombëtare të Turizmit (AKT) dhe në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve ose Albania Investment Development Agency (AIDA).

3. Nga auditimi, sipas Autorizimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me nr. 1191/3 prot. datë 21.02.2017, rezultoi se, Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT), si Autoritet Kontraktor, ka realizuar 3 (tre) procedura prokuruese, gjatë vitit buxhetor 2016, për prodhim dhe promovim të turizmit shqiptar në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar, në kuadër të zhvillimit të projektit të zbatimit të brandimit të “Albania go your Oën Èay”, sipas aktit ligjor VKM nr.1195. datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve e të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në mediat e shkruara, dhe në kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”.

-Mbi auditimin në lidhje me zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, të procedurës, “Mbi përgatitjen e një spoti promociional me rastin e kampionatit EUROPIAN Francë 2016” me fond limit 1, 683,333 lekë pa TVSH, e realizuar në qershor të vitit 2016, pranë Agjencisë Kombëtare të Turizmit (AKT), rezultoi:

-Kjo procedurë është iniciuar, nga ish-Ministri i MZHETTS me objekt mbi promovimin e turizmit në Euro 2016, në Francë. Mbi bazën e konfirmimit të porosisë të datës 07.03.2016, e firmosur nga ish-Ministri i MZHETTS me përfaqësuesin e ..., për të cilën në MZHETTS nuk ka dokumentacion shpjegues për këtë kontratë paraprake, e cila do të transmetonte spotin duke u paguar me vlerën prej 90 mijë Euro, nga buxheti i shtetit.

-Titullari i AKT-së, me Urdhër nr.278 prot. datë 03.06.2016 ka përcaktuar “Ngritjen e komisionit” i cili do të përcaktojë specifikimet teknike dhe studimin e tregut për përcaktimin e fondit limit si dhe ka përcaktuar specifikimet teknike, duke e paraqitur sipas kostove të shërbimit që përbëjnë spotin prej 10” (sekonda).

-Titullari i AKT-së, ka nxjerrë Urdhërin nr.79. datë 06.06.2016, “Për fillim procedure për prodhimin e 1 spoti promocional “Shqipëria në Euro 2016”. Në këtë urdhër është ngritur dhe komisioni për hartimin e dokumentave dhe ndjekjen e procedurave. Komisioni, po në datë 06.06.2016, ka hartuar, miratuar dhe dërguar Ftesë për Negociata tre kompanive si dhe është hedhur në faqen e internetit të institucionit të AKT. Këto ftesa zyrtare nuk mbajnë konfirmimin nga operatorët ekonomik përkatës për vënien në dijeni të procedurës (orën dhe datën), në një kohë kur kërkohet paraqitja e ofertës dhe dokumentacionit, pa kaluar 24 orë.!, gjë që të shtyn të mendosh që këto kërkesa janë formale dhe të pamunduara të realizohen për kohën e vendosur në dispozicion nga AKT-ja.

-Procedura ka vazhduar në datën 07.06.2016, ku në orën 10:30 janë paraqitur të interesuar dy kompani, të cilat nuk bëjnë pjesë tek operatorët, që komisioni iu kishte dërguar Ftesat për negociim. Ofertat janë paraqitur në protokollin e AKT-së, nga subjektet si më poshtë:

1. nr.278/9 prot me ofertë prej 1,510,000 lekë pa TVSH, e cila nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë të kërkuar, e për rrjedhojë është skualifikuar.

2. nr.278/10 prot me ofertë prej 1,470,000 lekë pa TVSH, e cila ka plotësuar dokumentacionin dhe është shpallur fituese nga komisioni i vlerësimit.

-Autoriteti Kontraktor i AKT-së, ka dërguar shkresën nr. 278/12 prot. datë 07.06.2016, me objekt njoftimin e klasifikimit si dhe hartuar dhe miratuar Raportin përmbledhës mbi procedurën për realizimin e 1 spoti promocional “Shqipëria në Euro 2016”.

-Nga AKT-ja, është lidhur Kontratë Shërbimi nr. 278/15 prot. datë 09.06.2016 me vlerë kontrate prej 1,764,000 lekë me TVSH, me kompaninë fituese.

–Nga Titullari i AKT-së, me Urdhër nr. 105. datë 09.06.2016 “Për ngritje komisioni të marrjes në dorëzim”, i cili e ka marrë në dorëzim, prodhimin e spotit në bazë të proces-verbalit të datës 13.06.2016 . Operatori fitues është paguar në bazë të Urdhër shpenzimit nr. 99. datë 17.08.2016.

-Nga auditimi konstatohet se, në bazë të “Konfirmim porosisë” së datë 07.03.2016, ky spot do të fillonte transmetimin prej datës 10 qershor deri në 10 korrik 2016, përgjatë eventit të Kampionatit European 2016, *ndërkohë spoti ishte gati më datë 13.06.2016*, pra tre ditë më vonë nga sa ishte parashikuar për transmetim. Pra, qëllimi mbi të cilin u procedua me një shpejtësi kohore, për të “prodhuar këtë spot” nuk u finalizua dot, si në kohë ashtu dhe në negociimin, duke e humbur objektin për të cilën u mendua që të reklamohet në këtë eveniment.

-Konstatohet se, ky spot nuk mundi të paraqitej për publikim, në ekranet e shpërndarë në territorin e shtetit të Francës, ku po zhvillohej Kampionati European i Futbollit 2016, me arsyetimin e shprehur në shkresën nr.278/15 prot, datë 22.06.2016, nga Titullari i AKT-së drejtuar Titullarit të MZHETTS-it, ku citohet se *“Gjatë korrespondencës me personin e kontaktit të Allied Media Group, AKT kërkoi vazhdimisht korrigjimin e datave dhe njëkohësisht dërgimin e faturës origjinale me firmë dhe vulë të njomë, pasi tashmë spoti ishte realizuar dhe pritej vetëm firmosja e kontratës së rregullt sipas datave të porosisë, për fillimin e procedurave. Në fillim të kërkesave tona, nga ana e Allied Media, u njoftuam se është bërë një gabim fillestar prej tyre dhe se periudha e transmetimit do të ishte nga data 27.06.2016 deri më datë 10.07.2016, pra 17 ditë më e shkurtër nga letra e konfirmimit të porosisë dhe se kjo ishte data e saktë për ta dhe nuk mund të ndryshohej. Vlen të theksohet se AKT ka kërkuar me insistim transmetimin e spotit gjatë datave që figurojnë në letrën e*

porosisë, mirëpo kërkesa në asnjë moment nuk u mor parasysh nga Gjithashtu AKT, kërkoj edhe një reduktim të kostos për transmetimin e spotit sipas datave 27.06.2016 - 10.07.2016, të dërguara prej tyre për të cilën do të kërkohej miratim nga Ministria, mirëpo edhe për këtë kërkesë nuk u mor një përgjigje. “Në këto kushte, duke qënë se Agjencia Kombëtare e Turizmit realizoi në kohë spotin prej 10 (sekondash) sipas autorizimit të datës 03.06.2016 në kuadër të promovimit të turizmit Shqiptar në Euro 2016 me fondet e projektit Go Your Own way, kërkojmë udhëzimet nga ana Juaj për vijimin e procedurave të mëtejshme me shoqërinë, pasi shkresa e dërguar nga Ju, autorizon AKT-në vetëm për realizimin e spotit dhe kryerjen e pagesës së transmetimit të tij nga data 10.06.2016-10.07.2016”.

Përgjigja e Titullarit të MZHETTS-it , ishte negative sipas emalit të datës 24.06.2016, duke mos e realizuar qëllimin për të cilin u prodhua spoti për 10’, spot i cili sipas auditimit rezultoi se është përdorur në promovimin gjatë Festivalit të Venecias dhe jo gjatë kampionatit Evropian.

Ecuria e marketingut të këtij spoti ka vazhduar në datë 25.08.2016, ku AKT-ja, i është drejtuar përsëri ish-Ministrit të MZHETTS, ku është kërkuar aprovimi për transmetimin e spotit promovues të Shqipërisë prej 10 (sekondash) i cili tashmë, duhej të shfaqej në Festivalin e Venecias 2016.

- MZHETTS-si me shkresën nr. 7099/1 prot, datë 30.08.2016, ka miratuar kërkesën e mësipërme.

Gjatë auditimit, konstatohet se:

-Ekziston komunikimi elektronik, me kompaninë me seli në Londër (Angli), me AKT përfaqësuar nga ish-drejtori i Marketingut në AKT, ku është pranuar spote në ditë për 11 ditë. Në këtë ofertë del e paqartë, që është spoti prej 10’(sekonda) i cili u prodhua nga kompania fituese si më sipër, për tu publikuar në “Euro 2016” apo kemi të bëjmë me ndonjë spot tjetër ? Në faturën e sjellë nga kompania e huaj London, flitet për spot 30’(sekonda).

- Nga auditimi i dosjes fizike, Kompania e cila ka ekskluzivitetin për transmetimin e spotit është me këto të dhëna) dhe nuk jepet asnjë dokumentacionin ligjor, asnjë argumentim faktesh, për lidhjen që kanë këto kompani “të përzgjedhura nga AKT”?

-Është realizuar pagesa me Urdhër-Shpenzimi nr. 153, datë 14.10.2016, në mbështetje të Urdhër “Për kryerje pagesë” nr.147, datë 10.10.2016, me shkresë nr. 508 prot datë 10.10.2016 nga Drejtori i Përgjithshëm AKT-së, përfituesi del ..

-Monitorimi i promovimit të spotit, i është besuar tërësisht kompanisë ku del përsëri e paqartë për kohëzgjatjen e spotit nëse është 10 sekonda apo 30 sekonda.

Pra, si konkluzion, institucioni qendror Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Turizmit,Tregtisë dhe Sipërmarrës (MZHETTS) dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT), nuk kanë pasur një vizion të qartë dhe të drejtë mbi mënyrën sesi e kanë menaxhuar këtë procedurë, prodhimin dhe publikimin këtij spoti, duke mos dhënë alternativa të qarta mbi publikimin dhe përzgjedhjen e kompanive të huaja, për të promovuar vendin tonë si një destinacion turistik në arenën ndërkombëtare, përgjegjësi kjo e MZHETTS-it dhe AKT-së, duke mos patur gjurmë të plota dokumentare, që nga faza e nisjes së prodhimit të spotit (i cili do të reklamohej gjatë Kampionatit Evropian) ashtu dhe nga përzgjedhja e aktivitetit të Venecias, për promovimin final të këtij spoti dhe mungesë dokumentacioni të plotë për monitorimin e tij. (*Trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Nga ana e MZHETTS-it si institucion qendror dhe nga AKT si njësi varësie, të merren të gjitha masat që prodhimet, publikimet dhe transmetimet e spoteve turistike, të planifikohen në kohë, të harmonizohen strukturat midis tyre, në përputhje me bazën ligjore, në mënyrë që për çdo hallkë të procedurës të kemi tablo të qartë, të transparencës, të nxitjes së konkurrencës, barazinë e operatorëve ekonomikë, për përdorimin efektiv të fondeve publike.

Menjëherë

4. Mbi auditimin në lidhje mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, të procedurës, “Për fushatën e Integruar e Marketingun për Promovimin e Turizmit “Albania Go Your Own way” me fond limit prej 51,800,000 lekë pa TVSH, realizuar në gusht të vitit 2016, pranë Agjencisë Kombëtare të Turizmit (AKT).

Nga auditimi u evidentua se, për të gjithë shërbimet e objektit, për procedurën e Fushatës së Integruar e Marketingut për Promovimin e Turizmit “Albania Go Your Own way”,

-Sipas shkresës nr. 6118 prot, datë 29.07.2016, janë përzgjedhur 2 këshilltarë nga kabineti i Ministrit të MZHETTS-it, në kundërshtim me Urdhrin nr. 5938, datë 22.07.2015 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të brendshëm, të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” Kreu II neni 6(Kabineti i Ministrit), e cila është strukturë ndihmëse, që shërben si organ këshillimor pranë Ministrit, duke ushtruar të gjitha funksionet e parashikuara në ligjin nr. 90/2012. Ndërkohë, në strukturën e MZHETTS, ekziston Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Turizmit, prej nga, Titullari, mund të kishte përzgjedhur anëtarët e grupit të punës ose nga strukturë tjetër kompetente në MZHETTS.

- Komisioni i vlerësimit, duhet të vendoste, kriteret teknike, të cilat duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar, duhet të vendoste kërkesa të veçanta për kualifikim, në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, me dokumenta konkrete që duhet të paraqisnin operatorët ekonomikë në përmbushje të kriterëve (dokumentacion financiar dhe ekonomik, licenca, dëshmi profesionale, nënkontraktime më të tretë për të realizuar objektin, kapacitete të burimeve njerëzore, etj), e për pasojë, do ta bënte më transparente mënyrën e prodhimit, publikimit dhe transmetimit të spoteve turistike.

-Mos monitorimi nga AKT-ja, me burime njerëzore të kualifikuara apo me personel të strukturave të turizmit në MZHETTS, nuk ka dhënë tablonë e qartë, të mënyrës së nënkontraktimeve, që operatori fitues, ka realizuar me operatorë vendas apo të huaj.

-Komisioni i mbikëqyrjes së kontratës të AKT-së, ka dokumentuar aktivitetin bazuar vetëm në dokumentacionin e firmës kontraktuese dhe pjesërisht të operatorit, duke treguar se nuk ka kapacitete të burimeve njerëzore që mund të monitorojnë , fondet publike të Buxhetit të Shtetit, bazuar në funksionin kryesor të AKT-së, promovimin e vendit tonë në fushën e turizmit.

Pra, institucioni qendror Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT), nuk kanë pasur një vizion të qartë dhe të drejtë mbi mënyrën sesi e kanë menaxhuar këtë procedurë për prodhimin, publikimin e transmetimin të spoteve turistike. (Trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandoj:

Nga ana e Titullarit të MZHETTS, të përcaktohen në komisione burime njerëzore, për realizimin e procedurave të prokurimeve, kur kërkohen nga njësitë e varësisë, persona kompetente në përshtatje me detyrat funksionale të përcaktuara dhe (jo këshilltarë të kabinetit), në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore.

Nga AKT-ja të merren masa për realizimin e monitorimit sa më të saktë dhe dokumentimin në mënyrë që të jenë sa më të besueshëm publikimi i spoteve turistike, si brenda dhe jashtë vendit.

Menjëherë

5. Mbi auditimin në lidhje me zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, të procedurës, “Për fushatën e Integruar e Marketingun për Promovimin e Turizmit “Albania Go Your Own way” e realizuar sipas VKM-së nr. 1195, datë 05.08.2008 me fond limit prej 9.600,000 lekë pa TVSH, realizuar në dhjetor të vitit 2016, pranë Agjencisë Kombëtare të Turizmit (AKT).

Nga auditimi rezultoi se, për të gjithë shërbimet e objektit, për procedurën e Fushatës së Integruar e Marketingut për Promovimin e Turizmit “Albania Go Your Own way”, nga auditimi u evidentua se:

- Komisioni i vlerësimit, duhet të vendoste, kritere teknike, të cilat duhet të garantonin cilësinë e kërkuar, duhet të vendoste kërkesa të veçanta për kualifikim, në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, me dokumenta konkrete që duhet të paraqisnin operatorët ekonomikë në përmbushje të kritereve (dokumentacion financiar dhe ekonomike, licenca, dëshmi profesionale, nënkontraktime më të tretë për të realizuar objektin, kapacitete të burimeve njerëzore, etj), e për pasojë, do ta bënte më transparent mënyrën e prodhimit, publikimit dhe transmetimit të spoteve turistike.

-Mos monitorimi nga AKT-ja, me burime njerëzore të kualifikuara apo me personel të strukturave të turizmit në MZHETTS, nuk ka dhënë tablonë e qartë, të mënyrës së nënkontraktimeve, që operatori fitues ka realizuar me operatorët ndërkombëtarë.

-Komisioni i mbikëqyrjes së kontratës të AKT-së, ka dokumentuar aktivitetin bazuar *vetëm* në dokumentacionin e firmës kontraktuese dhe pjesërisht të operatorit, duke treguar se nuk ka kapacitete të burimeve njerëzore që mund të monitorojnë, fondet publike të Buxhetit të Shtetit, bazuar në funksionin kryesor të AKT-së, promovimin e vendit tonë në fushën e turizmit.

Pra, institucioni qendror Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT), nuk kanë pasur një vizion të qartë dhe të drejtë mbi mënyrën sesi e kanë menaxhuar këtë procedurë për prodhimin, publikimin e transmetimin të spoteve turistike. (*Trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Nga ana e MZHETTS-it si institucion qendror dhe nga AKT si njësi varësie, të merren të gjitha masat që prodhimet, publikimet dhe transmetimet e spoteve turistike, të planifikohen në kohë, të harmonizohen strukturat midis tyre, në përputhje me bazën ligjore, në mënyrë që për çdo hallkë të procedurës të kemi tablo të qartë, të transparencës, të nxitjes së konkurrencës, barazinë e operatorëve ekonomikë, për përdorimin efektiv të fondeve publike.

Menjëherë

6. Nga auditimi i realizuar, sipas Autorizimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me nr. 1191/4 prot datë 21.02.2017, pranë Agjencisë Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ose Albania Investment Development Agency (AIDA) si Autoritet Kontraktor, konstatohet se, është realizuar 1(një) procedurë me objekt: *“Botimi në median e shkruar ndërkombëtare të një artikulli për promovimin e Shqipërisë”* me fond limit prej 36,000,000 lekë me TVSH e siguruar nga Buxheti i Shtetit.

-Nga auditimi rezultoi se nga ana e komisionit është përgatitur ftesa për negociata, e cila është publikuar vetëm në eëb-in e AIDA-s, dhe nuk është shpërndarë me korrespondencë zyrtare, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 1195, datë 05.08.2008 *“Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radioteleviziv ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”* pika II (Procedura për realizimin e një programi, të një reklame apo spoti) nënpika 9.

-Nga AKT-ja, në zbatim të nenit 23 të Statutit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve dhe pikës 2 të kontratës nr. 3/5 datë 13.01.2016, është kryer pagesa e kompanisë sipas faturës së datës 26.01.2016”, duke mos u shoqëruar me dokumentacionin përkatës për çdo element përbërës të procedurës. Nuk jepet asnjë informacion, mbi shpërndarjen e 5000 kopjeve të revistës *“The Economist”* në Davos, si dhe 1500 kopjeve në Shqipëri.

Për këtë rekomandoj:

Nga ana e AIDA-s, të merren të gjitha masat, duke analizuar mbi mënyrën e ecurisë së publikimeve, duke respektuar bazën ligjore, për çdo hallkë të procedurës dhe veçanërisht

monitorimi i kontratës, për të pasur përdorim sa më efektiv, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike.

Menjëherë

7. Nga auditimi i dokumentacionit që administrohet në dosjen e procedurës për marrje me qira të pasurisë publike nga shoqëria konstatohet se, për vitin 2015 kjo shoqëri nëpërmjet programit “Për nxitjen e punësimit”, ka përfituar financime buxhetore nëpërmjet programit të nxitjes së punësimit për 91 punonjës. Fakt që tregon se, punësimi nuk ka ardhur si rrjedhojë e favorizimit nëpërmjet kontratës simbolike “1 Euro” por nëpërmjet fondeve publike të financuara nga “Shërbimi kombëtar i punësimit”. Për këtë, shoqëria që administron këtë pronë, së bashku me grupin e monitorimit, nuk kanë pasqyruar dhe llogaritur diferencën e mundshme midis vendeve të punës sipas kushteve të kontratës me vendet e punës të financuara nëpërmjet përfitimit nga fondet e “shërbimit kombëtar të punësimit”; dhe për çdo vend pune të pa çelur, shoqëria të penalizohej në masën *50,000 lekë për çdo vend pune të pahapur*, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 7 “penalitetet” pika 7.2 e kontratës.

- Nga monitorimi i kontratave të qirave rezulton se dhe shoqëria nivelin e punësimit e ka arritur nëpërmjet projekteve të nxitjes së punësimit, të përfituara nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, pa ndarë vendet e punës të çelura nga vetë shoqëria me ato të financuara nëpërmjet projekteve. (*Trajtuar më hollësisht në pikën V të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Drejtoria e Pronës Publike pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, së bashku me Komisionet e Monitorimit të kontratave të hartojnë një program të përbashkët me “Shërbimin Kombëtar të Punësimit”, me qëllim evidentimin e të gjithë shoqërive qiramarrëse që kanë përfituar fonde publike për punësim dhe penalizimin e atyre sipërmarrësve që kanë krijuar vende të reja pune nëpërmjet fondeve publike, duke i raportuar vende pune të krijuara nga kontrata favorizuese “1 Euro”.

Menjëherë

8. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëritë prodhuese me që kanë ndryshuar kushtet e kontratave të mëparshme, nga pagesa me qira mujore për metër/katror në kontrata favorizuese simbolike “1 Euro”, konstatohet se: Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore zënë rreth 80 % të koston së prodhimit, madje deklarohet se, aktiviteti që zhvillon kjo shoqëri favorizohet së tepërmi nga kosto e ulët e fuqisë punëtore, e cila në Shqipëri varion nga 8 deri 12 herë më e ulët se në Austri dhe Gjermani (lënda e parë e porositesit nuk kontabilizohet në shpenzimet e prodhimit).

Në lidhje me këtë situatë të favorshme që gjejnë këto shoqëri, Drejtoria Pronës Publike në MZHETTS, në kërkesat për kualifikim dhe favorizimin e tyre nëpërmjet ndryshimit të kushteve të kontratës nga lekë/m² në kontrata simbolike “1 Euro”, nuk ka përcaktuar kritere dhe rregulla të veçanta për mbrojtjen e të punësuarve.

Nga verifikimi i kryer rezultoi se, në asnjë rast nuk janë vendosur kushte për nivelin e pagave dhe depozitimin e formularit të pagesës së sigurimeve shoqërore model si për aktivitetin fillestar që kryen para zgjerimit të pronës ashtu edhe gjatë monitorimit të kontratës simbolike “1 Euro”, që krahas deklaramit të investimeve të kryera, të depozitojnë edhe formularin model miratuar nga Degët e Tatimit Taksat, për justifikimin e çeljes së vendeve të reja të punës me pagat referuese të Këshillit Ministrave, moshën e çdo të punësuarit, me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të shtetasve shqiptarë të punësuar, si dhe mbrojtjen nga shfrytëzimi i fëmijëve të mitur nën 16 vjeç. (*Trajtuar më hollësisht në pikën V të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

Drejtoria e Pronës Publike në MZHETTS, në kërkesat për kualifikim në procedurat e dhënies me qira të pasurisë publike të përcaktojë kritere dhe rregulla të veçanta për

mbrojtjen e të punësuarve. Pas lidhjes së kontratës, në një nen të veçantë të vendosen kushte për kontraktuesin që në marrëdhëniet e punësimit detyrimisht të vendoset si referencë paga minimale e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Po kështu edhe gjatë fazave të monitorimit për zbatimin e detyrimeve kontraktuale, pjesë e dokumenteve të monitorimit të jetë edhe formulari i sigurimeve shoqërore model miratuar nga Degët e Tatim Taksat, si dokument bazë për justifikimin e çeljes së vendeve të reja të punës.

Menjëherë

C.MASA DISIPLINORE:

Për personat përgjegjës në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet titullarit të institucionit të MEF për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore sipas përgjegjësisë individuale të personave konkret, nga vërejtje deri në largim nga puna.

Menjëherë

D.TË TJERA

1.Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2018.

11. TË TJERA MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE.

1. Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja “k”, KLSH për mos zbatimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara do tu drejtohet:

- Kuvendit të Shqipërisë, duke kërkuar të ketë në vëmendje rekomandimet tona;

-Komisionit të Ekonomisë dhe Financave pranë Kuvendit të Shqipërisë, duke kërkuar edhe ndihmën e tij për të sensibilizuar institucionet për rëndësinë e rekomandimeve në rritjen e përgjegjshmërisë në administrimin e fondeve publike; si edhe

- Kryeministrit të Shqipërisë, për miratimin e një vendimi apo urdhri në lidhje me dhënien e një vlere detyruese, zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.

2. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2018.

3. Rekomandimet që rezultojnë të pazbatuara nga auditimi i ushtruar “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të 9-mujorit të vitit 2017”, do të përcillen në subjekte brenda datës 30.07. 2018.

4. Nëse nuk merren masa, nga ana e subjekteve, për shpërblimin e dëmit, kontabilizimin dhe ndjekjen në rrugë ligjore për arkëtimin e tyre, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimin, brenda muajit Shtator 2018, veprimet dhe mosveprimet nga ana e tyre, si titullar Institucioneve, do të përcillen pranë Institucionit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R